



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 282, datë 10.12.2019

PËR

SKUALIFIKIMIN E KANDIDATIT Z. {...}, PËR NË FORMIMIN FILLESTAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS, PËR MAGJISTRAT, PROFILI GJYQATAR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 10.12.2019, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatorja znj. Marçela Shehu, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për skualifikimin e kandidatit z. {...} për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2019-2020,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Z. {...} është kandidat për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili gjyqtar, në kushtet kur:

- a) është vlerësuar nga Shkolla e Magjistraturës, në bazë të Raportit të Vlerësimit Përfundimtar të datës 01.04.2019, se plotëson kriteret e pranimit në formimin fillestar për magjistrat sipas nenit 28 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si Ligji i Statusit);
- b) ka marrë pjesë në provimin e organizuar nga Shkolla e Magjistraturës sipas nenit 31 të Ligjit të Statusit, duke u përfshirë në listën e renditjes së kandidatëve fitues në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, të miratuar me Vendimin nr. 11, datë 15.05.2019, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkresën nr. 1588 prot., datë 27.05.2019 (protokolluar me nr. 2898 prot., datë 27.05.2019).

2. Me Vendimin nr. 83, datë 05.06.2019, mbështetur në nenin 32 të Ligjit të Statusit, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës për

kandidatët për magjistratë, profili gjyqtarë, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat, ku në bazë të shortit, për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...} si relatore u caktua znj. Marçela Shehu.

3. Më datë 14.06.2019, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati, z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua :

- për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit;
- për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi;
- për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

Po ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

4. Brenda afatit treditör, kandidati, z. {...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidati nuk parashtrori asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Më datë 14.06.2019, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati, z. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

6. Brenda afatit pesëditor, kandidati, z. {...}, depozitoi formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit 21 ditör (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ai dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

7. Në vijim të procedurës së verifikimit, në datat 25.06.2019 dhe 28.06.2019, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenin 32 të Ligjit të Statusit, për kandidatët për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për z. {...}.

8. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

9. Gjatë procedurës së verifikimit, pas kërkimit dhe dhënies nga kandidati, në rrugë elektronike, të të dhënave të punësimit, më datë 25.06.2019, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion nga institucionet që

kanë mbikqyrur disiplinën në punë të kandidatit z. {...}, të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

10. Pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, duke çmuar se procedura e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin {...}, ishte e plotë dhe në përputhje me kërkesat e Vendimit 75/2019, më datë 05.11.2019, relatorja e parashtrori çështjen përpara Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

11. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e shqyrtoi çështjen me datë 05.11.2019 dhe, pasi vlerësoi të plotë procedurën e verifikimit në këtë rast, bazuar në pikën 3, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e saj për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kualifikimin ose skualifikimin e kandidatit {...} për në formimin fillestar për magjistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magjistraturës.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR KRITERET E PRANIMIT NË FORMIMIN FILLESTAR TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

A. Për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat

1. Sa i përket kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, përfshirë edhe për kandidatin {...}, si dhe më lart u parashtrua, vlerësimi për plotësimin e tyre është bërë, në momentin e kandidimit, nga ana e Shkollës së Magjistraturës, bazuar kjo në nenin 30¹ (“Kandidimi dhe vlerësimi paraprak i kandidatëve”) të Ligjit të Statusit. Në përfundim të vlerësimit, Shkolla ka përgatitur dhe i ka paraqitur Këshillit të Lartë Gjyqësor raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat, ku pas komenteve të Këshillit, më datë 01.04.2019, Shkolla ka miratuar dhe publikuar në faqen e saj zyrtare Raportin e Vlerësimit Përfundimtar, përfshirë dhe listën e kandidatëve, të cilët plotësonin kriteret e parashikuara në nenin 28 të Ligjit të Statusit. Në këtë listë është përfshirë dhe kandidati {...}.

¹ “1. Shkolla e Magjistraturës pranon aplikimet për pranimin në formimin fillestar, deri në fund të muajit shkurt të çdo viti.

2. Kandidatët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm që vërteton përmbushjen e kriterëve të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kriterëve, nuk është i plotë, i saktë, ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, Shkolla e Magjistraturës mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga organet publike ose punëdhënësit e kandidatit.

3. Deri në datën 15 mars të çdo viti, Shkolla e Magjistraturës kryen një vlerësim paraprak, nëse kandidati përmbush kriteret e kandidimit, të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji.

4. Shkolla e Magjistraturës i paraqet Këshillave raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat. Këshillat mund të japin komente ose kundërshtime jo më vonë se në fund të muajit mars të çdo viti. Shkolla e Magjistraturës miraton raportin e vlerësimit përfundimtar, duke marrë në konsideratë komentet dhe kundërshtimet e bëra, dhe publikon raportin e vlerësimit përfundimtar në faqen e saj zyrtare, duke përfshirë listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 28 të këtij.

5. Çdo kandidat, i cili nuk është përfshirë në listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret, ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore të ankimit, të parashikuara në ligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe aktet nënligjore përkatëse”.

2. Gjithsesi, për kandidatin {...}, u konsiderua verifikimi sërish i disa prej kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, përcaktuar në nenin 28 të Ligjit të Statusit.

2.1 Për këtë u mbajt në konsideratë diferenca kohore mes momentit të aplikimit të kandidatëve (Shkurt 2019), momentit të vlerësimit përfundimtar nga Shkolla e Magjistraturës për plotësimin e kriterëve nga ana e tyre (1 Prill 2019), si dhe momentit aktual, kur Këshilli duhet të shprehet për kualifikimin ose jo të kandidatëve për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, të cilët kanë rezultuar fitues në provimin e pranimit (Shtator 2019). Dhe po ashtu, nga ana tjetër, u mbajt në konsideratë dhe fakti se shumica e kriterëve të pranimit në formimin fillestar janë potencialisht të ndryshueshëm në kohë (me përjashtim të kriterit arsimor, kriterit të përvojës profesionale, kriterit të anëtarësisë në parti politike, në kohën e kandidimit dhe kriterit të anëtarësisë, bashkëpunëtorit ose të favorizuarit nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990).

2.2 Gjithashtu, për këtë u mbajt në konsideratë se një verifikim i tillë është detyrim ligjor për Këshillin e Lartë Gjyqësor që buron nga neni 32 ("Verifikimi i pasurisë dhe figurës")², pika 4,

² 1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të pasurisë dhe figurës.

2. Brenda një jave nga publikimi i listës përfundimtare, sipas nenit 31, të këtij ligji, për secilin kandidat të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë.

3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre.

4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet në Shkollën e Magjistraturës kur:

a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asetë ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të asetëve;

b) raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar";

c) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit.

5. Deri në datën 5 shtator të çdo viti, Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre.

6. Kandidatët kanë të drejtë të njihen me dosjen dhe të ankohen në gjykatën kompetente ndaj vendimit të Këshillave, brenda 5 ditëve. Gjykata kompetente vendos për ankimin, brenda dy javëve nga paraqitja e tij.

7. Pas përfundimit të verifikimit të pasurisë dhe figurës, Këshillat miratojnë dhe publikojnë në fund të muajit shtator të çdo viti, listën përfundimtare të kandidatëve magjistratë, që pranohen në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar trevjeçar, në përputhje me numrin e kandidatëve të përcaktuar sipas nenit 29 dhe duke respektuar me përpikëri renditjen e kandidatëve në listën e parashikuar në pikën 2, të nenit 31, të këtij ligji.

shkronja “c”, të Ligjit të Statusit, sipas të cilit Këshilli ka detyrimin të verifikojë ekzistencën e çdo shkaku përjashtues (të parashikuar nga ligji) nga kandidimi për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Përveç kësaj, u mbajt në konsideratë detyrimi i Këshillit për verifikimin e kriterëve të zgjedhshmërisë, të cilat janë njëherazi edhe kriteret e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, pra, ato sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit, është një detyrim konstant i Këshillit qoftë në momentin e emërimit të të diplomuarve për magistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magjistraturës, ashtu edhe gjatë karrierës së tyre si magistrat (gjyqtar), referuar për këtë në nenet 35, 64 dhe 66 të Ligjit të Statusit.

3. Konkretisht, për kandidatin {...} u verifikua :

a) *pasja nga ai i zotësisë së plotë për të vepruar*, ku për këtë nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë;

b) *pasja e shtetësisë shqiptare*, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, është depozituar dokumenti Letërnjoftim, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 04.08.2010, ku pasqyrohet përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, që në këtë rast pasqyrohet “shqiptare”, ndërkohë që gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare për këtë kandidat;

c) *gjendja gjyqësore*, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, ky i fundit ka kryer verifikim në regjistrin elektronik gjyqësor të administruar nga Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve), duke printuar në letër Çertifikatë Elektronike datë 20.02.2019, ndërkohë që gjatë verifikimit, në kuadër të verifikimit të figurës së kandidatit, u administruan Shkresa nr. V-2125/1 prot., datë 04.07.2019, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore). Sipas këtyre dokumenteve, kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë;

ç) *disiplina në punë*, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës është depozituar vërtetimi datë 06.02.2019 lëshuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare dhe vërtetimi datë 15.02.2019 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Ndërkohë që gjatë verifikimit u administrua shkresa datë 17.07.2019 nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës pranë Ministrisë së Drejtësisë, Zyra Vendore Tiranë, shkresa datë 17.07.2019 nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, si dhe shkresa datë 08.07.2019 lëshuar nga Universiteti “{...}”{...} Nga këto dokumente rezulton se kandidati nuk është larguar nga puna për shkaqe disiplinore;

d) *qënia bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete*, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim në të cilën deklaron se nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete, ndërkohë që gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për qënien e kandidatit bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

4. Për kriteret e tjera të pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës u konsiderua vlerësimi i bërë nga kjo e fundit dhe konkretisht për :

a) *pasjen e kriterit arsimor*, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, është depozituar dokumenti “Diplomë” Bachelor në Drejtësi, me nr. {...}, datë {...}, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, si dhe Vërtetim Notash datë 15.04.2013, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë; “Diplomë” Master i Shkencave në Drejtë Penale, me nr. {...}, datë {...}, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, si dhe Vërtetim Notash datë 18.09.2014, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë;

b) *pasjen e përvojës profesionale*, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës është depozituar dokumenti “Librezë Pune”, sipas të cilit kandidati ka përvojë profesionale aktive me kohë të plotë si specialist jurist dhe përgjegjës sektori pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës pranë Ministrisë së Drejtësisë, Zyra Vendore Tiranë për periudhën 24.05.2013 – 28.02.2017, si specialist jurist pranë Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare për periudhën 01.03.2017 – aktualisht në fillimin e shkollës;

c) *mos anëtarësinë në parti politike në kohën e kandidimit*, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim në të cilën deklaron se nuk është anëtar i ndonjë partie politike;

ç) *mosqënien anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990*, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim në të cilën deklaron se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990, përveç se referuar moshës së tij (i datëlindjes {...}), ai nuk mund të ketë qenë i tillë.

5. Për sa më sipër, rezulton që kandidati për në formimin fillestar {...} plotëson kriteret e përgjithshme e të veçanta për t’u pranuar në formimin fillestar për magjistrat, në kuptim të nenit 28 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”

B. Për kriterin e pasurisë sipas nenit 32 të Ligjit të Statusit

1. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

2. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 43/29 prot., datë 19.08.2019.

2.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidati {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

2.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit është kryer kontrolli i plotë për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidati {...}, duke konkluduar se për kandidatin rezultonte:

- *Fshehje në deklaratën e pasurisë të kandidatit të pasurisë tokë arë me sipërfaqe totale 12.273 m², të përfituara me AMTP nr. {...} nga kandidati, në bashkëpronësi si anëtar i familjes bujqësore.*
- *Krijohet bindja se kandidati dhe personat e lidhur me të, kanë përfiturar në mënyrë jo të ligjshme pasuritë tokë arë dhe truall me sipërfaqë totale 10.500 m², të ndodhur në fshatin Luz i Vogël Kavajë me AMTP nr. {...}, pasi familja bujqësore ka përfiturar tokë bujqësore më parë me AMTP nr. {...}.*
- *Fshehje të kontratës së qirasë nr. 6286/883, nëpërmjet së cilës kandidati si pjesë e familjes bujqësore merr pjesën takuese nga qiraja e lidhur për një afat 20 vjecar, për sipërfaqen 3.600 m² tokë/arë (pasuria nr. {...}) e ndodhur në Luz i Vogël) për çmimin e deklaruar prej 20.000 lekë në vit, nga pala qiradhënëse shtetasi {...} {...}.*
- *Mungesë burimi financiar të ligjshëm për shumën 33.400 euro, e cila është përdorur për likuidimin e blerjes së pasurisë apartament nr. {...}, me sipërfaqe 74.7 m², i ndodhur në Selitë Tiranë. Kësti i parë në shumën 16.700 euro është likuiduar sipas kontratës së porosisë nr. {...} më datë {...} dhe kësti i dytë sipas kësaj kontrate do të paguhet me datë {...}, fakt i cili konfirmohet dhe në kontratën e shitjes nr. {...}, datë {...}.*
- *Pala shitëse e automjetit Smart është i njëjti shtetas {...} që ka blerë automjetin Mercedes Benz CLK 270 CDI, për rrjedhojë krijohet dyshimi lidhur me shumatat reale të shitjes dhe blerjes së automjeteve, pasi veprimet janë kryer jashtë zyrës noteriale dhe jo me transaksione bankare. Vlera e shitjes së automjetit CLK pas 6 vjetësh përdorim është më e madhe se vlera e blerjes se tij në vitin 2011.*
- *Subjekti ka përfiturar dy herë pagë në muajin mars 2017, konkretisht nga AMF dhe nga DPSHP.*
- *Subjekti rezulton se është i dy punësuar duke përfiturar dy paga brenda të njëjtit muaj për periudhat, korrik-shtator 2013, korrik-gusht 2014, qershor-shtator 2016, qershor e shtator 2017 dhe qershor-shtator 2018, konkretisht tek subjekti privat {...} dhe tek Institucioni DPSHP.*
- *Mungesë burimi ligjor lidhur me blerjen e apartamentit në Tiranë me sip.127.4 m² në shumën 5.000.000 lekë nga shtetësja {...}{...}. Referuar të ardhurave të krijuara nga shtetësja {...}{...} deri në momentin e blerjes së asetit janë në shumën rreth 3.260.000 lekë pa zbritur shpenzimet e konsumit, ndërsa prindërit sipas dokumentacionit të paraqitur rezultojnë të punësuar me paga të ulëta. Gjithashtu, referuar dokumentacionit prindërit e shtetases {...}{...} kanë të regjistruar në emër të tyre në të njëjtën ndërtesë pasurinë apartament me sip. 127.4 m². Për rrjedhojë, nuk ka informacion mbi kostot e përdorura për jetesë, për ndërtimin e banesës nga prindërit e saj dhe nëse këta shtetas kanë kryer blerje ose investime në pasuri të tjera.*
- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor mbi dhuratat nga dasma në shumën 900.000 lekë dhe mbi shpenzimet martesore në shumën 800.000 lekë, deklaruar në vitin 2018.*

- *Përveç sa është trajtuar më sipër, ILDKPKI ka dërguar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit Aktin Përfundimtar të Kontrollit të Plotë të Rivlersimit Kalimtar të subjektit {...} {...} (babai i kandidatit), me funksion Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit {...}, në datë 20.09.2018, në përfundim të të cilit janë konstatuar problemet si vijon; deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, ka kryer fshehje të pasurive, ka kryer deklarime të rreme, ka qënë në situatën e konfliktit të interesave.*

2.3 Sipas Raportit të ILDKPKI-së, “Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr.9049, datë. 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjin nr.9367, datë.07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe ligjin nr.96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konstatohet se për kandidatin {...};

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;*
- ka kryer fshehje të pasurisë;*
- nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

3. Më datë 28.08.2019, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Kreu IX, Seksionin A, pika 11, shkronja b, të Vendimit 75/2019, kandidati, z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua :

- *për përfundimet e raportit të ILDKPKI-së, raport ky që i është bashkëngjitur njoftimit;*
- *për të drejtën që kishte për të paraqitur shpjegime dhe dokumenta të tjera përpara Këshillit, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.*

4. Brenda afatit ligjor, kandidati, z. {...}, depozitoi pretendimet e tij lidhur me raportin e ILDKPKI-së duke i shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

5. Marrë shkas nga shpjegimet e kandidatit dhe dokumenteve mbështetës të paraqitur prej tij, me shkresën nr. 3210/3 prot., datë 02.09.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor i kërkoi ILDKPKI-së raportim shtesë për kandidatin z. {...}, duke i dërguar dhe dokumentacionin përkatës të kandidatit.

6. Me shkresën nr. 3332/6 prot., datë 16.09.2019, ILDKPKI-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, ka përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor Raportin Shtesë, sipas të cilit për kandidatin z. {...} rezultonte:

- *Mungesë burimi financiar të ligjshëm për shumën 33.400 euro, e cila është përdorur për likuidimin e blerjes së pasurisë apartament nr. {...}, me sipërfaqe 74.7 m2, i ndodhur në {...}. Kësti i parë në shumën 16.700 euro, është likuiduar sipas kontratës së porosisë nr. {...}, më datë {...} dhe kësti i dytë sipas kësaj kontrate do të paguhet me datë {...}, fakt i cili konfirmohet dhe në kontratën e shitjes nr. {...}, datë {...}.*
- *Pala shitëse e automjetit Smart është i njëjti shtetas {...} që ka blerë automjetin Mercedes Benz CLK 270 CDI, për rrjedhojë krijohet dyshimi lidhur me shumat reale*

të shitjes dhe blerjes së automjeteve, pasi veprimet janë kryer jashtë zyrës noteriale dhe jo me transaksione bankare. Vlera e shitjes së automjetit CLK pas 6 vjetësh përdorim është më e madhe se vlera e blerjes se tij në vitin 2011.

- Subjekti rezulton se është i dy punësuar duke përfituar dy paga brënda të njëjtit muaj për periudhat, korrik-shtator 2013, korrik-gusht 2014, qershor-shtator 2016, qershor e shtator 2017 dhe qershor-shtator 2018, konkretisht tek subjekti privat {...} dhe tek Institucioni DPSHP.
- Mungesë burimi ligjor lidhur me blerjen e apartamentit në Tiranë me sip.127.4 m2 në shumën 5.000.000 lekë nga shtetësja {...}. Referuar të ardhurave të krijuara nga shtetësja {...} deri në momentin e blerjes së asetit janë në shumën rreth 3.260.000 lekë pa zbritur shpenzimet e konsumit, ndërsa prindërit sipas dokumentacionit të paraqitur rezultojnë të punësuar me paga të ulëta. Gjithashtu, referuar dokumentacionit prindërit e shtetases {...} kanë të regjistruar në emër të tyre në të njëjtën ndërtesë pasurinë apartament me sip. 127.4 m2. Për rrjedhojë, nuk ka informacion mbi kostot e përdorura për jetesë, për ndërtimin e banesës nga prindërit e saj dhe nëse këta shtetas kanë kryer blerje ose investime në pasuri të tjera.
- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor mbi dhuratat nga dasma në shumën 900.000 lekë dhe mbi shpenzimet martesore në shumën 800.000 lekë, deklaruar në vitin 2018.
- Përveç sa është trajtuar më sipër, ILDKPKI ka dërguar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit Aktin Përfundimtar të Kontrollit të Plotë të Rivlersimit Kalimtar të subjektit {...} {...} (babai i kandidatit), me funksion Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Kavajë, në datë 20.09.2018, në përfundim të të cilit janë konstatuar problemet si vijon; deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, ka kryer fshehje të pasurive, ka kryer deklarime të rreme, ka qënë në situatën e konfliktit të interesave.

6.1 Sipas Raportit Shtesë të ILDKPKI-së, “Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr.9049, datë. 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjin nr.9367, datë.07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe ligjin nr.96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konstatohet se për kandidatin {...} :

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

7. Më datë 17.09.2019, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi dëgjoi relatorin e çështjes dhe u njoh me materialet e saj sa i përkiste gjetjes së procedurës së verifikimit në lidhje me kriterin e pasurisë së kandidatit, referuar përcaktimeve të nenit 32 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Seksionit A, Kreu IX të Vendimit nr. 75 datë 23.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor

“Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, ka vendosur njoftimin e kandidatit {...} mbi gjetjen e procedurës së verifikimit, duke e ftuar për të paraqitur shpjegime si dhe çdo dokumentacion mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të tij.

8. Me datë 23.09.2019, kandidati, z. {...}, depozitoi pretendimet e tij lidhur me raportin shtesë të ILDKPKI-së, duke i shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

9. Edhe në këtë rast, marrë shkas nga shpjegimet e kandidatit dhe dokumenteve mbështetës të paraqitur prej tij, me shkresën nr. 3210/6 prot., datë 26.09.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor i kërkoi ILDKPKI-së raportim shtesë për kandidatin z. {...}, duke i dërguar dhe dokumentacionin përkatës të kandidatit.

10. Me shkresën nr. 3332/11 prot., datë 09.10.2019, ILDKPKI-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, ka përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor Raportin e Dytë Shtesë, sipas të cilit për kandidatin z. {...} rezultonte:

- *Mungesë burimi financiar të ligjshëm për shumën rreth 1.800.000 lekë për blerjen e apartamentit me nr. {...}, me sipërfaqe 74.7 m2, në vlerën totale 33.400 euro, i ndodhur në {...}.*
- *Pala shitëse e automjetit Smart është i njëjti shtetas {...} që ka blerë automjetin Mercedes Benz CLK 270 CDI, për rrjedhojë krijohet dyshimi lidhur me shumën reale të shitjes dhe blerjes së automjeteve, pasi veprimet janë kryer jashtë zyrës noteriale dhe jo me transaksione bankare. Vlera e shitjes së automjetit CLK pas 6 vjetësh përdorim është më e madhe se vlera e blerjes së tij në vitin 2011.*
- *Subjekti rezulton se është i dy punësuar duke përfutur dy paga brenda të njëjtit muaj për periudhat, korrik-shtator 2013, korrik-gusht 2014, qershor-shtator 2016, qershor e shtator 2017 dhe qershor-shtator 2018, konkretisht tek subjekti privat {...} dhe tek Institucioni DPSHP.*
- *Mungesë burimi të ligjshëm në shumën totale rreth 2.500.000 lekë lidhur me blerjen e apartamentit në Tiranë me sip.127.4 m2, në shumën 5.000.000 lekë, nga shtetësja {...} {...}.*
- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor mbi dhuratat nga dasma në shumën 900.000 lekë dhe mbi shpenzimet martesore në shumën 800.000 lekë, deklaruar në vitin 2018.*
- *Përveç sa është trajtuar më sipër, ILDKPKI ka dërguar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit Aktin Përfundimtar të Kontrollit të Plotë të Rivlersimit Kalimtar të subjektit {...} {...} (babai i kandidatit), me funksion Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit {...}, në datë 20.09.2018, në përfundim të të cilit janë konstatuar problemet si vijon: - deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; - nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; - ka kryer fshehje të pasurive; - ka kryer deklarime të rreme; - ka qënë në situatën e konfliktit të interesave.*

10.1 Sipas Raportit të Dytë Shtesë të ILDKPKI-së, “Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr.9049, datë. 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjin nr.9367, datë.07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe ligjin nr.96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konstatohet se për kandidatin {...};

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

11. Më datë 09.10.2019, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Vendimin 75/2019, kandidati, z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua :

- për përfundimet e raportit të dytë shtesë të ILDKPKI-së, raport ky që i është bashkëngjitur njoftimit;
- për të drejtën që kishte për të paraqitur shpjegime dhe dokumenta të tjera përpara Këshillit, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

12. Me datë 18.10.2019, kandidati, z. {...}, depozitoi pretendimet e tij lidhur me raportin e dytë shtesë të ILDKPKI-së, duke i shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

13. Edhe në këtë rast, marrë shkas nga shpjegimet e kandidatit dhe dokumenteve mbështetës të paraqitur prej tij, me shkresën nr. 3788/28 prot., datë 31.10.2019 Këshilli i Lartë Gjyqësor i kërkoi ILDKPKI-së raportim shtesë për kandidatin z. {...}, duke i dërguar dhe dokumentacionin përkatës të kandidatit.

14. Me shkresën nr. 3332/16 prot., datë 08.11.2019, ILDKPKI-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, ka përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor Raportin e Tretë Shtesë, sipas të cilit për kandidatin z. {...} rezultonte:

- Mungesë burimi financiar të ligjshëm për shumën rreth 1.800.000 lekë për blerjen e apartamentit me nr. {...} me sipërfaqe 74.7 m2, në vlerën totale 33.400 euro, i ndodhur në {...}.
- Pala shitëse e automjetit Smart është i njëjti shtetas {...}, që ka blerë automjetin Mercedes benz CLK 270 CDI, për rrjedhojë krijohet dyshimi lidhur me shumën reale të shitjes dhe blerjes së automjeteve, pasi veprimet janë kryer jashtë zyrës noteriale dhe jo me transaksione bankare. Vlera e shitjes së automjetit CLK, pas 6 vjetësh përdorim, është më e madhe se vlera e blerjes së tij në vitin 2001.
- Subjekti rezulton se është i dypunësuar duke përfutur dy paga brenda të njëjtit muaj për periudhat korrik - shtator 2013, korrik - gusht 2014, qershor - shtator 2016, qershor e shtator 2017 dhe qershor - shtator 2018, konkretisht tek subjekti privat {...} dhe tek institucioni DPSHP.

- Mungesë burimi të ligjshëm në shumën totale rreth 2.500.000 lekë lidhur me blerjen e apartamentit në Tiranë me sip. 127.4 m², në shumën 5.000.000 lekë, nga shtetësja {...}{...}.
- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, mbi dhuratat nga dasma në shumën 900.000 lekë dhe mbi shpenzimet martesore në shumën 800.000 lekë, deklaruar në vitin 2018.
- Përveç sa është trajtuar më sipër, ILDKPI ka dërguar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit “Aktin Përfundimtar të Kontrollit të Plotë të Rivlerësimit Kalimtar të Subjektit {...} {...} (Babai i kandidatit) me funksion Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}” në datë 20.09.2018 në përfundim të të cilit janë konstatuar problemet si vijon : deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, ka kryer fshehje të pasurive, ka kryer deklarime të rreme, ka qenë në situatën e konfliktit të interesave.

14.1 Sipas Raportit të Tretë Shtesë të ILDKPKI-së, “Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë. 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konstatohet se për kandidatin {...};

- f) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- g) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- h) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- i) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- j) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

15. Më datë 11.11.2019, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Vendimin 75/2019, kandidati, z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua:

- për përfundimet e raportit të tretë shtesë të ILDKPKI-së, raport ky që i është bashkëngjitur njoftimit;
- për të drejtën për të dhënë qëndrimin e tij përfundimtar.

16. Me datë 13.11.2019, kandidati, z. {...}, depozitoi pretendimet e tij lidhur me raportin final të ILDKPKI-së, duke parashtruar argumentet si më poshtë:

1) Në lidhje me konstatimin “Mungesë burimi financiar të ligjshëm në shumën 1.800.000 lekë për shumën në total prej 33.400 euro, e cila është përdorur për likuidimin e blerjes së pasurisë apartament nr. {...}, me sipërfaqe 74.7 m², i ndodhur në {...}. Kësti i parë në shumën 16.700 euro është likuiduar sipas kontratës së porosisë nr. {...}me datë {...} dhe kësti i dytë sipas kësaj kontrate do paguhet me datë {...}, fakt i cili konfirmohet dhe në kontratën e shitjes nr. {...} datë {...}.”, dhe pretendimit të parashtruar në Raport për mungesë dokumentacioni ligjor nga zyrat e tatim taksave për fitimin e realizuar dhe për dividendin e tërhequr për periudhën 2010-2013”:

Nga përlllogaritja e të ardhurave të mia nga aktiviteti privat në {...}, {...}, {...}, me nr. Nipti {...}, sipas vërtetimit nr. 780 Prot, datë 29.08.2019 (dokument ligjor nga zyra e tatim taksave ish-komuna Kryevidh vënë në dispozicion të ILDKPKI) rezulton se për vitet 2010 - 2013 kam realizuar xhiro totale 12.450.000 Lekë të reja, të shpërndara si mëposhtë: Viti 2010 - 1 900 000 Lekë; Viti 2011 - 2 900 000 Lekë; Viti 2012 - 3 800 000 Lekë; Viti 2013 - 3 850 000 Lekë.

Nga ana ime, është respektuar detyrimi dhe afati ligjor për dorëzimin e Deklaratës Parashikuese të Qarkullimit, pranë zyrës së taksave vendore pranë {...} (si institucion i vetëm tatimor kompetent në përmbushjen e detyrimeve tatimore deri në vitin 2013), gjë e cila ka çuar edhe në vlerësimin e detyrimeve tatimore për vitet 2010 - 2013.

Për xhiron totale 12 450 000 Lekë të reja për vitet 2010 - 2013 kam realizuar fitim në total 7.800.000 Lekë të reja të shpërndara si mëposhtë: Viti 2010 - 1 000 000 Lekë; Viti 2011 - 1 300 000 Lekë; Viti 2012 - 2 800 000 Lekë, Viti 2013 - 2 700 000 Lekë.

Gjithashtu, sqaroj se këto të ardhura të realizuara nga aktiviteti im privat familjar në {...}, {...}, {...}, me nr. Nipti {...} janë deklaruar ndër vite edhe nga babai im z. {...} {...} {...} si subjekt deklarues pranë ILDKPKI.

Theksoj se këto informacione ILDKPKI i ka patur në dispozicion të shoqëruar me aktet mbështetëse si xhiro e realizuar, detyrimet tatimore, sigurimet shoqërore, taksa vendore etj që prej vitit 2010 e në vazhdim. Gjithashtu, edhe në sqarimet e bëra nga babai im për shkak të kontroleve me ose pa short pranë ILDKPKI, nuk janë evidentuar probleme në njohjen e këtyre të ardhurave. Pretendimi i ILDKPKI për pamundësinë e konfirmimit të këtyre të ardhurave nuk qëndron pasi bie në kundërshtim me aktet që ka patur në dispozicion dhe aktet mbështetëse të dërguara nga ana ime.

Është absurde që ILDKPKI të dalë në një konkluzion të tillë se aktiviteti im dhe i familjarëve të mi për këto vite nuk {...} sjellë fitime kur provat mbështetëse të observacionit tim të parë dhe të dytë provojnë krejt të kundërtën. Ky konkluzion është i pamundur të arrihet edhe për faktin se ILDKPKI i ka pasur në dispozicion këto të dhëna edhe në deklaratimet ndër vite të babait tim gjyqtar bashkë me provat që ka paraqitur. Është fakt i njohur publik gjithashtu që unë dhe familjarët e mi prej vitesh nuk njohim pushime verore me qëllim angazhimin total për të shtuar të ardhurat e familjes nga të cilat rrjedhin asetet e vëna nga ana jonë.

Kam theksuar edhe në observacionet e mëparshëm se këto të ardhura (jo xhiro) nuk janë deklaruar nga ana ime përpara asnjë institucioni tatimor pasi nuk e kam pasur këtë detyrim dhe, si aktivitet i kategorizuar si “biznes i vogël”, përveçse deklarimit të xhiros, detyrim i cili është përmbushur nga ana ime ndër vite pranë organeve përkatëse të pushtetit lokal, si autoritet përgjegjës i ngarkuar me ligj në këto vite. Gjithashtu, ky aktivitet i kategorizuar si “biznes i vogël”, person fizik nuk ka pasur as detyrimin për të shpërndarë dividend, siç pretendon ILDKPKI.

Ky aktivitet duke u kategorizuar si subjekt tregtar “biznesi i vogël”, nga viti 2010 - 2013, i është nënshtruar detyrimeve tatimore të miratuara sipas vendimeve të Këshillit të ish-Komunës Kryevidh, në përputhje me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” si dhe udhëzimeve apo vendimeve në plotësim apo sqarim të mëtejshëm të këtij ligji, konkretisht udhëzimi nr 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore”, por ILDKPKI edhe në Raportin

Përfundimtar nuk shprehet për këtë fakt ligjor (për mospasjen e detyrimit për deklarimin e fitimit nga biznesi i vogël) megjithëse nga ana ime është cituar baza ligjore.

Lidhur me pretendimin se fitimi i përllogaritur rreth 63% të qarkullimit gjykohet të jetë shumë i lartë për aktivitetin e kryer, sqarohet se:

Ky pretendim i ILDKPKI nuk qëndron pasi nuk mbështetet në asnjë studim apo informacion për % e fitimit që realizon ky lloj aktiviteti. Aktiviteti i ushtruar nga ana ime konsiston në shërbime bar, restorant dhe çadra e shazllone plazhi. Në këtë lloj aktiviteti sezonal është fakt i njohur publik që ka një normë fitimi shumë të lartë për shkak të aktivitetit sezonal ku çdo produkt shitet mbi dyfishin e vlerës së blerjes. Vetëm për xhiron e realizuar nga aktiviteti i dhënies me qera ditore të çadrave dhe shezlloneve fitimi është shumë i lartë, pothuajse në nivelin e xhiros pasi nuk ka asnjë kosto ndryshe nga shërbimet e tjera bar, restorant etj. Pavarësisht argumentimit tim dhe vënies në dispozicion të vërtetimit nr. 780 Prot, datë 29.08.2019 (dokument ligjor nga zyra e tatim taksave ish-komuna {...} vënë në dispozicion të ILDKPKI) ku rezulton se për vitet 2010- 2013 kam realizuar xhiro totale 12.450.000 Lekë të reja si dhe pavarësisht deklarimeve ndër vite pranë ILDKPKI (që prej 2010, të cilat disponohen dhe janë njohur nga ILDKPKI ndër vite) të fitimit të realizuar nga aktiviteti i ushtruar prej meje nuk është marrë parasysh nga ILDKPKI edhe në këtë raport përfundimtar.

Lidhur me pretendimin për të ardhurat e realizuara ndër vite nga prodhimet bujqësore të shitura pranë subjektit Agro import-eksport Lika:

Në pretendimin e mëparshëm të ILDKPKI kam sqaruar se:

“Në lidhje me këtë fakt sqarohet se përfaqësuesi i subjektit Agro import-eksport {...}, z. {...} i cili ka lëshuar vërtetimin ka qenë aktiv që prej vitit 1998 si person fizik me nr. {...} dhe më pas ka qenë aktiv si SH.P.K me nr. {...}, sqaruar në observacionin e mëparshëm. Në lidhje me shitjet e prodhimeve bujqësore pranë subjektin {...} si person fizik dhe më pas si person juridik, sqarohet se kanë qenë në shuma të vogla në periudha kohore të ndryshme vjetore dhe pagesa bëhej cash në momentin e shitjes së prodhimeve, sipas vërtetimit të vënë në dispozicion në observacionin e mëparshëm. Gjithashtu ju përsëris sqarimin e dhënë edhe në observacionin e mëparshëm se prodhimet bujqësore e blegtorale janë deklaruar ndër vite nga babai im dhe vijnë nga të mbjellat e tokat që ndodhen në fshatin {...}, përfshirë këtu edhe tokën e marrë me qera gjyshit {...} {...}, taksat e të cilave janë shlyer ndër vite. Gjithashtu, edhe në sqarimet e bëra nga babai im për shkak të kontroleve me ose pa short pranë ILDKPKI, nuk janë evidentuar probleme në njohjen e këtyre të ardhurave. Pretendimi i ILDKPKI për mungesë dokumentacioni përkatës dhe fiktivitet të deklarimit të babait tim në lidhje me të ardhurat nga prodhimet bujqësore nuk qëndron.”

Pavarësisht provave të paraqitura sa më sipër, si dhe deklarimeve ndër vite të këtyre të ardhurave të ligjshme pranë ILDKPKI, përsëri qëndrimi i këtij institucioni është i pandryshueshëm.

Lidhur me pretendimi se teprica (diferenca e të ardhurave dhe shpenzimeve) për vitin 2013 CASH në shumën rreth 3.607.534 lekë dhe për vitin 2014 në shumën rreth 2.756.502 lekë nuk është e vërtetë pasi nuk është deklaruar nga babai im {...} {...} në formularin e deklarimet për vitin 2013 dhe 2014. Gjithashtu ILDKPKI përmend edhe procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI në datë 24.03.2015.

Fakti që teprica nuk është deklaruar nga babai im qëndron (tepricë e cila rezulton si e ardhur e ligjshme e deklaruar dhe e njohur si e ardhur e ligjshme në vitin paraardhës) dhe kjo pasaktësi ka ardhur për shkak të mospasjes dijani nëse duheshin pasqyruar tepricat në cash në formularët e deklarimeve dhe mënyrës sesi duheshin pasqyruar, kjo edhe për shkak të formularëve të përdorur të cilët i mëshonin vetëm të ardhurave të realizuara dhe shpenzimeve të subjektit deklarues për vitet përkatëse. Kjo pasaktësi në deklarim nga babai im nuk e përjashton faktin e ekzistencës së këtyre të ardhurave të ligjshme (të njohura nga ILDKPKI si të tilla) si tepricë nga viti paraardhës pasi nuk kishte arsye përse të mos deklaroheshin këto teprica të ligjshme kur ato ekzistonin. Kjo tepricë Cash nuk është deklaruar as nga personat e lidhur me babain tim (anëtarët e tjerë të familjes) për shkak të formularëve të përdorur në deklarime, mospasjes dijani nëse duheshin pasqyruar tepricat në cash në to si dhe mënyrës sesi duheshin pasqyruar. Fakti që familja ime ushtronte disa aktivitete tregtare si dhe faktit që kemi qënë në marrëdhënie pune përforcon pretendimin tim për pasjen e gjendjes Cash si burim i ligjshëm nga teprica e vitit paraardhës që ka shërbyer për pagesën e kështit të parë.

Gjithashtu, kjo pakujdesi në deklarimet e bëra nga babai im {...} {...} nuk e përjashton përdorimin e këtyre të ardhurave dhe për më tepër nuk mund të përbëjë mungesë burimi të ligjshëm për blerjen e apartamentit, duke u bërë shkak për penalizimin tim në të drejtën time për të filluar studimet për formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës.

Në përllogaritjen e të ardhurave të realizuara si burim për blerjen e apartamentit në dy këste (Kësti i parë në shumën 16.700 euro është likuiduar sipas kontratës së porosisë nr. 2121/1079 me datë 22.4.2014 dhe kësti i dytë sipas kësaj kontrate do paguhet me datë 22.4.2015), ILDKPKI kur i është referuar Deklaratave periodike të babait tim nuk ka marrë parasysh të ardhurat e realizuara në vitin 2013 të cilat kanë shërbyer në pagesën e kështit të parë (prill 2014), në shumën si mëposhtë:

1- Paga e babait si gjyqtar.	1.143.863 lekë
2- Prodhime bujqësore e blegtorale.	300.000 lekë
3- {...} {...} aktivitet market {...}.	1.000.000 lekë
4- {...} {...} aktivitet sezonal ambulant në {...} Golem.	150.000 lekë
5- {...}, aktivitet privat të ardhura nga bar piceri, çadra plazhi në Spille.	2.700.000 lekë
6- {...}, të ardhura nga Shërbimi Provës.	318.907 lekë
7- {...} {...}, të ardhura nga KQZ.	124.158 lekë
8- {...} {...}, të ardhura nga puna si Avokat.	203.946 lekë
9- {...} {...}, interesa nga Fondi Investimeve Raiffeisen.	318.726 lekë
10- {...} {...}, interesa banka Societe Generale.	63.889 lekë
11- {...} {...}, interesa banka Intesa San Paolo.	103.000 lekë

➤ Në këto përllogaritje për të ardhurat nuk janë deklaruar të ardhurat e gjyshërve të mi:

- {...} {...} pension në shumën	189.590 lekë
- E ndjera {...} {...} {...} pension në shumën	70.256 lekë
- E ndjera {...} {...} {...} pagesë verbërie në shumën	131.199 lekë

(Sgarim: Këto të ardhura nuk kanë qënë të detyrueshme për tu deklaruar ndër vite nga babai im si subjekt deklarues, të ardhura të deklaruara në Deklarimin në kuadrin e Vetingut)

TOTAL 6.817.534 Lekë

Në deklaratën e interesave private “Periodik Vjetor 2013”, babai im {...} {...} ka deklaruar **shpenzime** si vijon:

- | | |
|---|----------------|
| 1- Investime në biznes familjar. | 200.000 lekë |
| 2- Shpenzime për blerje ndërtesave tokë magazinë. | 1.470.000 lekë |

Shpenzimet për konsum familjar minimal në shumën rreth 1.540.000 sipas ILDKPKI për vitin 2014.

Totali i shpenzimeve të mbuluara nga të ardhurat e vitit 2013: Investime në biznes familjar në shumën 200.000 lekë, shpenzime për blerje ndërtesave tokë magazinë {...} {...} në shumën 1.470.000 lekë dhe shpenzimet për konsum familjar minimal në shumën rreth 1.540.000 sipas ILDKPKI, që shkojnë **në total 3.210.000 Lekë**.

Teprica vetëm për vitin 2013 (të ardhura minus shpenzime) rezulton në shumën rreth 3.607.534 Lekë (tepricë e ligjshme e dalë nga përlllogaritja e të ardhurave të mësipërme të njohura nga ILDKPKI), shumë e konsiderueshme dhe e justifikuar ligjërisht si burim financimi për këstin e parë 16.700 Euro (2.340.000 lekë).

- Në lidhje me pagesën e këstit të dytë (paguar në prill 2015) kanë shërbyer **të ardhurat** e realizuara në vitin 2014, të pasqyruara edhe në deklaratën e interesave private **“Periodik Vjetor 2014”**

- | | |
|---|---------------------|
| 1- Paga babait si gjyqtar. | 1.393.593 lekë |
| 2- Prodhime bujqësore e blegtorale.
(Sqarim: Trajtuar më sipër) | 600.000 lekë |
| 3- {...} {...} aktivitet market Kavajë. | 400.000 lekë |
| 4- {...}, aktivitet privat të ardhura nga bar piceri çadra plazhi në {...} . | 400.000 lekë |

(Sqarim: Të ardhurat nga aktiviteti im dhe aktiviteti i nënës time {...} {...} janë pasqyruar në shumën 0 lekë (xhiro dhe fitimi sipas vërtetimit të Drejtorisë Rajonale Durrës) për shkak të një lapsusi në paraqitjen e të dhënave në sist {...} C@ts, deklaratë kjo e ndryshuar respektivisht nga unë dhe nëna ime në korrik-shtator të vitit 2019 kur kemi ardhur në dijeni të këtij fakti. Pavarsisht këtij fakti, deklarimi pranë ILDKPKI për vitin 2014 nga babai im është bërë i saktë. Përsëri nga ILDKPKI edhe në Raportin e fundit e llogarit 0 Lekë.)

- | | |
|--|---------------------|
| 5- {...}, të ardhura nga Shërbimi Provës. | 570.516 lekë |
| 6- {...} {...}, të ardhura nga puna si Avokat. | 1.056.384 lekë |
| 7- {...} {...}, interesa nga Fondi Investimeve Raiffeisen. | 276.772 lekë |
| 8- {...} {...}, interesa banka Societe Generale. | 65.622 lekë |
| 9- {...} {...}, interesa banka Intesa San Paolo. | 102.124 lekë |
| 10- Tepricë në të ardhura nga viti paraardhës. | 1.000.000 lekë |

(Sqarim: Në deklaratën e vitit 2013 janë deklaruar vetëm të ardhurat dhe shpenzimet, dhe jo teprica. Teprica e pasqyruar në deklaratën e 2014 ka rezultuar pas zbritjes së shpenzimeve të realizuara në vitin 2013 si dhe të pagesës së këstit të parë në prill 2014. Kjo përlllogaritje është bërë në momentin e përpilimit të deklaratës së 2014, në muajin mars 2015. Ky fakt lidhet edhe me deklarimin e

babait tim në procesverbalin e vitit 2015 të përmendur nga ILDKPKI për gjendjen në cash në shuma minimale për vitin 2013 pasi kjo tepricë e vitit 2013 ishte përdorur në fillim të vitit 2014 për pagesën e këstit)

➤ Në këto përllogaritje për të ardhurat nuk janë deklaruar të ardhurat e gjyshërve të mi:

- {...} {...} pension në shumën 195.368 lekë
 - E ndjera {...} {...} {...} pension në shumën 72.223 lekë
 - E ndjera {...} {...} {...} pagesë verbërie në shumën 126.800 lekë
- (Sqarim: Këto të ardhura nuk kanë qenë të detyrueshme për tu deklaruar ndër vite nga babai im si subjekt deklarues, të ardhura të deklaruara në Deklarimin në kuadrin e Vetingut)

TOTAL 6.259.402 Lekë

Në seksionin e ndryshimeve të pasurive babai im ka deklaruar:

- 1- Kontratë porosie apartament, {...}, paguar ½ vlerës. 2.340.000 lekë
(Sqarim: Kësti i parë (paguar në prill 2014) është paguar nga të ardhurat e realizuara në vitin 2013 si tepricë e ngelur për vitin 2014 si dhe kursimet nga vitet e mëparshme.)
- 2- Dhënie hua, {...}t. 2.000.000 lekë
(Sqarim: Hua e dhënë nga llogaria e nënës time {...} {...} e deklaruar ndër vite si kursim dhe jo nga të ardhurat e 2014, konfirmuar edhe nga ILDKPKI)
- 3- Investim në Fondin e Investimit. 1.962.900 lekë

Totali i shpenzimeve të mbuluara nga të ardhurat e vitit 2014: Investim në Fondin e Investimit në shumën 1.962.900 lekë dhe shpenzimet për konsum familjar minimal në shumën rreth 1.540.000 sipas ILDKPKI, në total 3.502.900 lekë.

Teprica për vitin 2014 rezulton në shumën rreth 2.756.502 Lekë, shumë e cila ka shërbyer si burim financimi për pagesën e këstit të dytë në vitin 2015, në shumën 16.700 Euro (2.293.000 lekë).

Në deklaratën e interesave private “Periodik Vjetor 2015”, babai im {...} {...} ka deklaruar të ardhura dhe shpenzime si vijon:

Në seksionin e të ardhurave:

- a) Paga vjetore e shtetasit {...} {...} 1.408.428 lekë
- b) Prodhime bujqësore dhe blegtorale {...} {...}
(Sqarim: Trajtuar më lart) 600.000 lekë
- c) Interesa nga investimi ne bono thesari dhe fond investimi 472.546 lekë
- d) Interesa nga depozita në bankën SGA 38.297 lekë
- e) {...} {...} biznes privat në Kavajë 994.075 lekë
- f) {...} {...} aktiviteti si avokat 829.761 lekë
- g) {...} {...}, interesi nga depozita e ISP 0 lekë
- h) {...} aktivitet privat Spille 1.382.000 lekë
- i) {...} te ardhura nga paga 591.853 lekë
- j) {...} dhe {...} shitje makine Mercedes Benz 500.000 lekë

datë 8.9.2015

k) {...} {...} paga këshill bashkiak	55.034 lekë
l) {...}, kthim borxhi	1.000.000 lekë

➤ Në këto përlllogaritje për të ardhurat nuk janë deklaruar të ardhurat e gjyshërve të mi:

- {...} {...} pension në shumën	198.677 lekë
- E ndjera {...} {...} {...} pension në shumën	73.350 lekë
- E ndjera {...} {...} {...} pagesë verbërie në shumën	135.560 lekë

(Sqarim: Këto të ardhura nuk kanë qenë të detyrueshme për t'u deklaruar ndër vite nga babai im si subjekt deklarues, të ardhura të deklaruara në Deklarimin në kuadrin e Vettingut)

Për vitin 2014, ILDKPKI ka marrë dhe përlllogaritur vetëm periudhën 4 mujore në përlllogaritjen e tij si burim financiar i ligjshëm për pagesën e këstit të parë që është paguar në datën 22.04.2014, nga e cila ka rezultuar rreth **1.188.000 lekë**, pa përfshirë shumën rreth **3.607.534 Lekë** (shumë e shërbyer për p{...}in e këstit të parë) të tepruara nga viti paraardhës 2013 si tepricë (diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve vjetore 2013), të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i nënës time {...} {...} (aktivitet vjetor tregtim artikuj të ndryshëm në Kavajë dhe jo sezonal veror siç përsërit ILDKPKI) në shumën 400.000 lekë, të ardhurat nga prodhimet bujqësore në shumën 600.000 lekë (sipas vërtetimit të lëshuar nga subjekti “Agro Import Eksport Lika” **vënë në dispozicion të ILDKPKI**) si dhe të ardhurat e gjyshërve në shumën 135.800 lekë për 4 mujorin e parë. Për periudhën 4 mujore shpenzimet për konsum familjar minimal janë mesatarisht 513.000 lekë sipas ILDKPKI, pa marrë parasysh 2 gjyshërit, të cilët kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e tyre. (sipas analizës së bërë në observacionin e mëparshëm)

Për vitin 2015, ILDKPKI ka marrë dhe përlllogaritur vetëm periudhën 4 mujore në përlllogaritjen e tij si burim financiar i ligjshëm për pagesën e këstit të dytë që është paguar në datën 22.04.2015, të ardhura në shumën rreth **1.924.000 lekë**, pa përfshirë shumën rreth **2.756.502 Lekë** (shumë e shërbyer për p{...}in e këstit të dytë) të tepruara nga viti paraardhës si tepricë si dhe të ardhurat e gjyshërve në shumën **135.800 lekë** për 4 mujorin e parë (të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e tyre). Për periudhën 4 mujore shpenzimet për konsum familjar minimal janë mesatarisht **537.000 lekë** sipas ILDKPKI, pa marrë parasysh 2 gjyshërit, të cilët kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e tyre. Gjithashtu, ILDKPKI kthimin e borxhit e ka llogaritur përgjatë gjithë vitit, ku në fakt ky borxh në shumën 1.000.000 lekë është kthyer para pagesës së këstit (sipas deklaratës noteriale nr. 7354 Rep. 1378 Kol. të datës 17.10.2019 ku vërtetohet se huaja në shumën 1.000.000 lekë është kthyer në datën 20.03.2015). Pra, në vitin 2015, përveç të ardhurave për periudhën 4 mujore, familja ka pasur në dispozicion borxhin e kthyer në shumën 1.000.000 lekë si dhe tepricën e vitit 2014 në shumën rreth 2.756.502 Lekë, të cilat justifikojnë dhe tejkalojnë shpenzimet për pagesën e këstit të dytë (rreth 2.293.000 lekë). (sipas analizës së bërë më lart)

Pretendimi i ILDKPKI edhe në këtë raport përfundimtar se aktiviteti privat i nënës time {...} {...} pjesën kryesore të fitimit e realizon gjatë muajve të verës nuk qëndron pasi në vitet 2014 dhe 2015 nuk ka ushtruar aktivitet sezonal as në {...}, e as në {...} referuar deklaratimeve të të ardhurave sipas viteve përkatës. Veprimtaria kryesore e aktivitetit ka qenë tregtim i artikujve të ndryshëm (market) në qytetin e {...} përgjatë gjithë vitit kalendarik duke filluar prej vitit

2002, referuar Historikut të QKR. ILDKPKI nuk ka marrë parasysh historikun e vënë në dispozicion nga ana ime ku vërtetohet ky fakt. Gjithashtu, dua të sqaroj se nëna ime {...} {...}, pavarësisht se kishte aktivitetin e saj që e ushtronte përgjatë gjithë vitit në tregtimin e artikujve të ndryshëm, gjatë sezonit të verës i përkushtohet aktivitetit sezonal të regjistruar në emrin tim pasi shihej më me interes dhe fitim nga ana jonë.

Në lidhje me aktivitetin e ushtruar nga ana ime është fakt i njohur publik dhe i provuar që ky aktivitet ka qenë ushtruar vetëm gjatë sezonit të verës, referuar historikut të biznesit tim ku detajohet fillimi dhe pezullimi i tij. Pra, të ardhurat e realizuara në sezonin veror të vitit 2014 duhet të ishin përllogaritur në likuidimin e kështit të dytë në prill 2015.

Sa më sipër, konstatimi i ILDKPKI për mungesë burimi financiar të ligjshëm në shumën 1.800.000 lekë për shumën në total 33.400 Euro për blerjen e apartamentit e paguar në 2 këste (2014 dhe 2015) nuk qëndron për arsye se:

- 1- Vetëm duke përllogaritur të ardhurat e mia nga aktiviteti privat për vitet 2010 - 2013 në shumën prej **7.800.000 Lekë**, për vitin 2014, shuma prej **400.000 lekë**, të ardhurat e punës time në Drejtorinë e Shërbimit të Provës Tiranë për vitin 2013 në shumën **318.907 Lekë** dhe për vitin 2014 në shumën **569.761 Lekë**, të ardhurat e mia për 4 muajorin e parë të 2015 në shumën **195,054 lekë**, të cilat **në total janë në shumën 9.283.722 lekë**, pa llogaritur burimet financiare të familjes time deri në momentin e blerjes së kësaj pasurie të detajuar sa më sipër në bazë të deklaratave periodike pranë ILDKPKI (sqaruar më lart).

ILDKPKI në analizën e bërë nuk i referohet të ardhurave të ligjshme të realizuara nga ana ime dhe e familjarëve të mi në total por i referohet vetëm atyre të dhënave që vlerëson ajo si të sakta konkretisht vetëm vërtetimit të DRT {...} (e cila nuk disponon informacion për periudhën para vitit 2014) nga viti 2014 duke anashkaluar në mënyrë të padrejtë të ardhurat e realizuara nga ana jonë të pasqyruara në vërtetimet e pushtetit vendor si organ përgjegjës për vitet 2010 - 2013. Ndërkohë për këto vite 2010 - 2013 nga organet e pushtetit vendor njihet vetëm detyrimet tatimore të përmbushura nga ana jonë;

- 2- ILDKPKI në këtë Raport të dytë ka marrë parasysh vetëm të ardhurat e deklaruara për 4 muajt e parë të vitit 2014 (kësti parë) dhe 4 muajt e parë të vitit 2015 (kësti i dytë) sipas Deklaratave periodike të babait tim dhe jo të ardhurat e deklaruara në vitin 2013 e më parë në gjendje cash apo të akumuluar në depozita bankare, të deklaruara ndër vite nga babai im si të ardhura të ligjshme;
- 3- Në përllogaritjen e të ardhurave për vitin 2014 dhe për periudhën 4 muajore të vitit 2015, ILDKPKI nuk ka marrë parasysh tepricat e viteve paraardhës, të ardhurat nga prodhimet bujqësore (sipas vërtetimit përkatës), të ardhurat e realizuara nga aktiviteti im {...} (aktiviteti sezonal për vitin 2014) dhe nënës time {...} {...} (aktiviteti i ushtruar përgjatë gjithë vitit 2014 - 2015), si dhe ka përllogaritur në shpenzimet për konsum familjar minimal edhe 2 gjyshërit, të cilët kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e tyre;
- 4- Fakti që familja ime në vitin 2014 i ka dhënë hua shtetasit {...} apo ka investuar në Fondin e Investimit tregon se të ardhurat për pagesën e apartamentit kanë qenë të mjaftueshme;

- 5- Në përlllogaritjen e të ardhurave për periudhën 4 mujore të vitit 2015, ILDKPKI nuk ka marrë parasysh kthimin e borxhit në shumën 1.000.000 lekë cash para pagesës së këstit të dytë, por kthimin e këtij borxhi e ka llogaritur përgjatë gjithë vitit 2015. Me qëllim saktësimin e dyshimeve të ILDKPKI në lidhje me këtë fakt të kthimit të borxhit në fillim të vitit 2015 kam vënë në dispozicion deklaratën noteriale të huamarrësit {...} nr. {...} Rep. {...} Kol të datës {...}ku vërtëtohet se huaja në shumën 1.000.000 lekë është kthyer në datën {...}.
- 6- Për vitin 2014 të ardhurat nga aktiviteti im dhe aktiviteti i nënës time {...} {...} janë pasqyruar në shumat 0 lekë (xhiro dhe fitimi sipas vërtetimit të Drejtorisë Rajonale {...}) për shkak të një lapsusi në paraqitjen e të dhënave në sist{...} C@ts për këtë vit nga ana e zyrës financiare, deklaratë kjo e ndryshuar respektivisht nga unë dhe nëna ime në korrik - shtator të vitit 2019 kur kemi ardhur në dijeni të këtij fakti. Pavarsisht këtij fakti, deklarimi pranë ILDKPKI për vitin 2014 nga babai im është bërë i saktë. Përsëri nga ILDKPKI edhe në Raportin e fundit e llogarit 0 Lekë.
- 7- Në deklaratimet e këtyre viteve rezultojnë se babai im ka përfutur interesa të konsiderueshme nga bankat, fakt që tregon se në llogaritë bankare ka pasur shuma të konsiderueshme, të mjaftueshme dhe të ligjshme për të mbuluar pagesën e apartamentin.
- 8- ILDKPKI, shpenzimet për konsum familjar minimal i ka përlllogaritur për 7 persona duke përfshirë edhe gjyshërit, por në deklaratat e pasurisë nuk janë deklaruar pensionet respektive të gjyshërve si dhe të ardhurat e gjyshes nga pagesa e verbërisë, Bashkia {...}. Këto të ardhura nuk kanë qenë të detyrueshme për tu deklaruar ndër vite nga babai im si subjekt deklarues, të ardhura të deklaruara në Deklarimin e përgjithshëm Veting. Edhe në analizën e këtij Raporti, ILDKPKI nuk i ka përlllogaritur si të ardhura të familjes të ardhurat e gjyshërve sipas trajtimit të mësipërm nga ana ime.
- 9- ILDKPKI i ka pasur në dispozicion dhe i njeh të ardhurat e realizuara në vitin 2013 të cilat rezultojnë të ligjshme dhe si tepricë në shumën 3.607.534 Lekë (shumë e shërbyer për p{...}in e këstin të parë) por nga ana tjetër nuk i përlllogarit si të tilla vetëm për shkak të pasaktësisë dhe pakujdesisë në deklarim nga babai im {...} {...} në formularin e deklaratimit për vitin 2013 dhe 2014. Këto të ardhura janë fakt i padiskutueshëm dhe nuk mund të konsiderohen burim i paligjshëm në blerjen e pasurisë.
- 10- Kosto minimale për jetesë nuk është në vlerën e përlllogaritur nga ILDKPKI pasi rreth 50% e kësaj vlere përballohej nga prodhimet bujqësore e blegtorale të deklaruara ndër vite që përdoreshin drejtpërdrejt për ushqim familjar si dhe faktit që të gjithë mallrat ushqimorë dhe industriale merreshin me çmimin e shumicës në marketin ku ushtronte aktivitetin nëna ime që prej vitit 2002.
- 11- Pakujdesitë në deklarimet e bëra nga babai im {...} {...} duke mos deklaruar tepricat (në vitin 2013 në shumën 3.607.534 lekë dhe në vitin 2014 në shumën 2.756.502 lekë, në total rreth 6.300.000 lekë të ardhura të njohura dhe deklaruara nga ILDKPKI) nuk mund të përbëjnë mungesë burimi të ligjshëm për blerjen e apartamentit, duke u bërë shkak për penalizimin tim në të drejtën time për të filluar studimet për formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës.

2) Në lidhje me konstatimin “Pala shitëse e automjetit Smart është i njëjti shtetas{...} {...} që ka bërë automjetin Mercedes Benz CLK 270 CDI, për rrjedhojë krijohet dyshimi lidhur

me shumet reale të shitjes dhe blerjes së automjeteve pasi veprimet janë kryer jashtë zyrës noteriale dhe jo me transaksione bankare. Vlera e shitjes së automjetit CLK pas 6 vjetësh përdorim është më e madhe se vlera e blerjes së tij në vitin 2011”:

Siç kam sqaruar edhe në observacionin e mëparshëm i cili nuk është marrë parasysh nga ILDKPKI, është fakt se automjeti Smart është blerë nga ana ime shtetasit{...} i cili ka blerë nga unë automjetin Mercedes Benz CLK 270 CDI, por ky fakt nuk mund të merret i dyshimtë në lidhje me vlerën e shitjes dhe blerjes së automjeteve pavarësisht se veprimet janë kryer jashtë zyrës noteriale dhe jo me transaksione bankare pasi Ligji nuk na detyron të kryenim domosdoshmërisht transaksione bankare.

Nuk është i vërtetë pretendimi se vlera e shitjes së automjetit CLK pas 6 vjetësh përdorim është më e madhe se vlera e blerjes së tij në vitin 2011, diferencë e cila rezulton në shumën 100.000 Lekë, për arsye se:

- *Vlera e blerjes është 3.500 Euro që konvertohej në kohën e blerjes 2011 në 490.000 Lekë.*
- *Ky çmim blerje ishte më i ulët sesa vlera e tregut në Shqipëri për shkak të kilometrave të tepërta që kishte përshkruar mjete dhe shërbimeve të pakryera (lyerje, goma, vaj dhe filtra të pandërruara si dhe disqe të dëmtuara) të cilat po të kryheshin në shtetin Italian ku është blerë mjete do të kishin kosto më të lartë.*
- *Vlera e doganës është paguar në shumën 150.000 Lekë*
- *Shpenzime transporti nga Italia (rreth 20.000 lekë), lyerje, riparime, përmirësime të ndryshme (rregullim tapicerie, disqe, kasetafon...etj) të kryera nga ana ime ndër vite në një vlerë rreth 200.000 Lekë. (përmirësime të cilat duken qartë edhe në njoftimin për shitje të bërë nga ana ime në shkurt 2017, vënë në dispozicionin Tuaj me emailin e datës {...})*

Në lidhje me shpenzimet për përmirësime të ndryshme (të pretenduara nga ILDKPKI për mungesë dokumentacioni) kam vënë në dispozicion vërtetimet si vijon:

- a) *Lyerje dhe riparim tapicerie, viti 2017 – 90.000 lekë (sipas vërtetimit të datës 17.10.2019, bashkëlidhur dhe fatura tatimore)
Sqarim: Lyerja nuk konsistonte në ndërrimin e ngjyrës së mjetit por në rifreskim të ngjyrës nga gërvishje dhe shenja të cilat nuk duken në foto, fakt ky që shihet me dyshime nga ILDKPKI.*
- b) *Disqe automjeti + goma të montuara, viti 2015 – 51.500 lekë (sipas vërtetimit të datës 15.10.2019)
Sqarim: ILDKPKI nuk e ka njohur këtë fakt në përmirësimet e mjetit.*
- c) *Kasetofon+navigator bordi, viti 2016 – 40.000 lekë (sipas vërtetimit të datës 15.10.2019)
Sqarim: ILDKPKI nuk e ka njohur këtë fakt në përmirësimet e mjetit.*

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga ILDKPKI në Raportin e dytë se automjeti i shitur nga ana ime në vlerën e mësipërme është rishitur nga blerësi në shumën 4000 Euro nuk mund të krijojë aspak dyshime për vlerën e saktë të shitjes nga ana ime. Ky çmim i rishitjes së këtij mjeti

megjithëse ka diferencë të vogël, mund të jetë bërë nisur nga gjendja teknike që mund të ketë pasur mjeti në momentin e rishitjes ose nga raporti që mund të ketë pasur shitësi{...} me blerësin {...}. Ky informacion i ri i ILDKPKI nuk mund të bëjë shkak për të vënë në dyshim vlerën e {...}shitjes së mjetit nga ana ime.

Gjithashtu me emailin e datës 09.10.2019 drejtuar Juve të nderuar, ju kam paraqitur bashkëlidhur edhe njoftimin e bërë nga ana ime në 26 shkurt 2017 (provë të cilën nuk e disponoja me parë) për shitjen e automjetit në faqen merrjep.al, ku evidentohet mjeti me targa {...}, përshkrimi i mjetit përfshirë edhe përmirësimet e bëra nga ana ime të sqaruara në observacionet, si dhe çmimi i paraqitur nga ana ime në shumën 5500 Euro (rreth 750.000 lekë, sipas kursit zyrtar në kohën e njoftimit), njoftim i cili provon dhe rrëzon çdo dyshim të mundshëm në lidhje me vlerën e shitjes.

Përshkrimi i bërë nga ana ime në publikimin e njoftimit për shitje ku ndër të tjera kam përmendur mundësinë e ndërrimit (+ -) diferencën në varësi të vlerave përkatëse të mjeteve përforcon akoma më tepër qëllimin tim në raport me faktin që ka ndodhur, pra më konkretisht blerësit të automjetit tim i kam ofruar mundësinë e këmbimit të automjeteve duke më kthyer diferencën për shkak të vlerës më të lartë që kishte mjeti im Benz (5500 Euro) në raport me mjetin Smart (300.000 Lekë), veprime këto të konkretizuara nëpërmjet kontratave përkatëse në të njëjtën ditë.

Dyshimet mbi vlerën reale të shitjes nga ILDKPKI nuk qëndrojnë edhe për faktin se njoftimi për shitjen e mjetit në shumën 5.500 Euro (rreth 750.000 lekë) është publikuar më datë 26 Shkurt 2017 dhe shitja e mjetit është realizuar më datë 02 Mars 2017, pra 4 ditë pas publikimit.

Sa parashtrova më lart, qartësoj çdo dyshim të ILDKPKI në këtë Raport lidhur me shumën reale të shitjes dhe blerjes së automjeteve pasi këto shit-blerje janë bërë me kontrata të rregullta para noterin publik në zbatim të neneve 710-739 të K. Civil si dhe parashikimeve të tjera ligjore.

3) Në lidhje me konstatimin “Subjekti rezulton se është i dy punësuar duke përfituar dy paga brenda të njëjtit muaj për periudhat, korrik - shtator 2013, korrik - gusht 2014, qershor - shtator 2016, qershor e shtator 2017 dhe qershor - shtator 2018, konkretisht tek subjekti privat {...} dhe tek institucioni DPSHP”:

Siç kam sqaruar edhe në observacionin e mëparshëm, është fakt i deklaruar edhe prej meje se ndër vite që kam qenë i vetëpunësuar (dhe jo i punësuar siç pretendohet në Raportet e ILDKPKI) që prej vitit 2010 e në vazhdim në aktivitetin sezonal privat familjar stacion plazhi në {...}, {...}, Bashkia {...}, me nr. Nipti {...}, duke paguar të gjitha detyrimet ligjore, përfshirë edhe sigurimet shoqërore ndër vite.

Puna ime si i vetëpunësuar nuk bie në kundërshtim me ligjin dhe nuk është në konflikt interesi me marrëdhëniet e mia të punës në cilësinë e punëmarrësit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe Universitetit “{...}” {...}, si lektor i jashtëm.

Ashtu siç kam parashtruar dhe më lart, është fakt i njohur publik që unë dhe familjarët e mi prej vitësh nuk njohim pushime verore për shkak të angazhimit total në periudhën e verës (kryesisht në muajin gusht) për të shtuar të ardhurat e familjes nga të cilat rrjedhin asetet e vëna nga ana jonë. Pavarsisht punësimi tim dhe familjarëve të mi nuk na ka penguar në

angazhimin pranë këtij aktiviteti familjar sidomos në muajin gusht ku realizohej gati 80% e të ardhurave. Gjithashtu, dua të sqaroj se nëna ime {...} {...}, pavarësisht se kishte aktivitetin e saj që e ushtronte përgjatë gjithë vitit në tregtimin e artikujve të ndryshëm, gjatë sezonit të verës i përkushtohej aktivitetit sezonal të regjistruar në emrin tim pasi shihej më me interes dhe fitim nga ana jonë.

Në këtë aktivitet përveç kontributit të familjarëve nënës dhe dy vëllezërve të cilët kanë qënë të angazhuar maksimalisht, kam pasur edhe punonjës të punësuar dhe të deklaruar në listpagesat pranë DRT {...} ndër vite, të konfirmuara edhe nga ILDKPKI në këtë Raport. Konkretisht listpagesat e viteve të fundit që disponoj ku rezultojnë të punësuar rreth 7 punonjës. Sqarimi i dhënë nga ana ime për angazhimin e familjarëve në këtë aktivitet nuk nënkupton që në këtë aktivitet kemi qënë të punësuar vetëm në familjarisht dhe asnjë punonjës tjetër në realizimin e të ardhurave, siç pretendon ILDKPKI, por nënkupton angazhimin maksimal të familjes time për shkak të rëndësisë që ka për ne ky aktivitet fitimprurës.

Gjithashtu, sqaroj se në kohën kur kam qënë i punësuar pranë AMF/SHP kam ezauruar lejen vjetore (1 muaj) gjatë periudhës së verës (kryesisht në muajin gusht) ndërsa për muajt e tjerë, unë personalisht e kam kryer punën tek aktiviteti privat pas orarit zyrtar të punës. Ritheksoj se aktiviteti i ushtruar nga ana ime ka qënë aktivitet sezonal dhe familjar, me orare të zgjatura darkave, çka do të thotë se përveç angazhimit tim, janë angazhuar edhe familjarët e tjerë (përfshirë këtu edhe të punësuarit prej meje) për shkak të rëndësisë që ka për ne ky aktivitet fitimprurës.

Sa parashtrova më lart, puna ime si i vetëpunësuar nuk bie në kundërshtim me ligjin dhe nuk ka qënë në konflikt interesi me punët pranë AMF/SHP. Gjithashtu, sqaroj se edhe nga ana e punëdhënësve AMF/SHP nuk ka pasur asnjë vërejtje qoftë verbale në lidhje me respektimin e orareve dhe prezencën në punë, përkundrazi kam pasur vetëm vlerësime pozitive qoftë nga ana profesionale ashtu edhe nga ana etike.

Sa më sipër, pavarësisht deklaramëve të mia dhe provave të paraqitura në observacionet e mëparshme, ILDKPKI edhe në këtë Raport Përfundimtar e interpreton si konstatim këtë fakt.

4) Në lidhje me analizën e të ardhurave të evidentuara nga ILDKPKI “Të ardhurat nga aktiviteti privat të konfirmuara nga dokumentacioni i depozituar në shumën totale rreth 10.154.732 lekë”:

“... Ky konkluzion nuk i përgjigjet faktit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion pasi në raportin e hartuar ILDKPKI ka marrë parasysh vetëm deklaratat e sistemit C@TS të vëna në dispozicion nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve {...} duke më konfirmuar vetëm shumën 10.154.732 të realizuar në vitet 2015 - 2018, pa më llogaritur të ardhurat e vitit 2014, në shumën 400.000 lekë (sipas shkresës nr. {...} Prot, datë {...} të DRT {...} drejtuar ILDKPKI dhe e disponuar prej saj), të cilat në total shkojnë 10.545.732 për vitet 2014 - 2018. (sqaruar në pikën 1)

ILDKPKI në raportin e hartuar në përllogaritjen e të ardhurave të mia në total nuk ka marrë parasysh të ardhurat që kam realizuar për vitet 2010 - 2013 në shumën 7.800.000 Lekë të reja por është mjaftuar vetëm me njohjen e nivelit të qarkullimit vjetor si dhe me njohjen e taksave dhe detyrimeve të paguara nga ana ime për këto vite 2010 - 2013 (sqaruar në pikën 1)

Nga përlllogaritja e të ardhurave të mia nga aktiviteti privat në {...}, {...}, Bashkia {...}, me nr. Nipti {...}, sipas vërtetimit nr. {...} Prot, datë {...} (dokument ligjor nga zyra e tatim taksave ish-komuna {...}vënë në dispozicion të ILDKPKI) rezulton se për vitet 2010- 2013 kam realizuar xhiro totale 12.450.000 Lekë të reja, të shpërndara si mëposhtë: Viti 2010 - 1 900 000 Lekë; Viti 2011 - 2 900 000 Lekë; Viti 2012 - 3 800 000 Lekë; Viti 2013 - 3 850 000 Lekë.

Nga ana ime, është respektuar detyrimi dhe afati ligjor për dorëzimin e Deklaratës Parashikuese të Qarkullimit, pranë zyrës së taksave vendore pranë Komunës {...} (si institucion i vetëm tatimor kompetent në përmbushjen e detyrimeve tatimore deri në vitin 2013), gjë e cila ka çuar edhe në vlerësimin e detyrimeve tatimore për vitet 2010 - 2013

Ritheksoj se këto të ardhura të realizuara nga aktiviteti im privat familjar në {...}, {...}, Bashkia {...}, me nr. Nipti {...} janë deklaruar ndër vite edhe nga babai im z. {...} {...} {...} si subjekt deklarues pranë ILDKPKI.

Këto të ardhura nuk janë deklaruar nga ana ime përpara asnjë institucioni tatimor pasi nuk e kam pasur këtë detyrim, si aktivitet i kategorizuar “biznes i vogël”, përveç deklarimit të xhiros, detyrim i cili është përmbushur nga ana ime ndër vite pranë organeve përkatëse të pushtetit lokal si autoritet përgjegjës në këto vite. (sqsuar në pikën 1)

Nga përlllogaritja e mësipërme rezulton se të ardhurat e realizuara nga aktiviteti im privat familjar në {...}, {...}, Bashkia {...}, me nr. Nipti {...}, janë në shumën 10.545.732 për vitet 2014 - 2018 të pasqyruara në sist{...} C@TS të Drejtorisë rajonale të Tatimeve {...} shtuar edhe të ardhurat për vitet 2010 - 2013 në shumën 7.800.000, të cilat në total arrijnë rreth 18.345.732 Lekë.

Sa më sipër, pavarësisht se nga ana ime është argumentuar se ky aktivitet duke u kategorizuar si subjekt i biznesit të vogël, nga viti 2010-2013, i është nënshtruar detyrimeve tatimore të miratuara sipas vendimeve të Këshillit të ish-Komunës {...}, në përputhje me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sist{...} e taksave vendore” si dhe udhëzimeve apo vendimeve në plotësim apo sqarim të mëtejshëm të këtij ligji, konkretisht udhëzimi nr 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore”, ILDKPKI edhe në Raportin e dytë nuk shprehet për këtë fakt ligjor (për mospasjen e detyrimit për deklarimin e fitimit nga biznesi i vogël) megjithëse nga ana ime është cituar baza ligjore.

Ashtu siç kam sqaruar dhe më lart në trajtimin e burimit të apartamentit, ritheksoj se këto informacione ILDKPKI i ka patur në dispozicion të shoqëruar me aktet mbështetëse si xhiro e realizuar, detyrimet tatimore, sigurimet shoqërore, taksa vendore etj, që prej vitit 2010 e në vazhdim. Gjithashtu, edhe në sqarimet e bëra nga babai im për shkak të kontrolleve me ose pa short pranë ILDKPKI, nuk janë evidentuar probleme në njohjen e këtyre të ardhurave. Pretendimi i ILDKPKI për pamundësinë e konfirmimit të këtyre të ardhurave nuk qëndron pasi bie në kundërshtim me aktet mbështetëse.

5) Në lidhje me konstatimin “Mungesë burimi ligjor në shumën 2.500.000 lekë, lidhur me blerjen e apartamentit në {...} me sip. 127.4 m2, në shumën 5.000.000 lekë, nga shtetasja{...}{...}. Referuar të ardhurave të krijuara nga shtetasja{...}{...} deri në momentin

e blerjes së asetit janë në shumën rreth 3.260.000 lekë pa zbritur shpenzimet e konsumit, ndërsa prindërit sipas dokumentacionit të paraqitur rezultojnë të punësuar me paga të ulëta”:

Nuk jam dakort me këtë konkluzion të ILDKPKI paraqitur në këtë Raport për faktin se bashkëshortja ime (si person i lidhur) së bashku me prindërit e saj kanë patur burime të mjaftueshme ligjore për blerjen e këtij apartamenti.

Në observacionin e parë kam sqaruar se referuar vërtetimit për bazën e vlerësuar nr. {...}Prot, datë {...}për Zj. {...}{...} si dhe vërtetimit nr. {...}Prot, datë {...}për Z. {...}{...} të ISSH, Drejtoria Rajonale {...}, në të cilët pasqyrohen vetëm pagat e hedhura në sistem nga viti 2012 e në vazhdim për dy prindërit e bashkëshortes time{...}{...}.

Rezulton se nga përlllogaritja e pagave të marra të ardhurat që prej vitit 2012 e deri në blerjen e apartamentit arrijnë shumën si mëposhtë:

	{...}{...}	{...}{...}
Viti 2012	260.000	281.000
Viti 2013	302.300	302.300
Viti 2014	265.700	314.600
Viti 2015	286.000	286.000
Viti 2016	312.000	312.000
Viti 2017	449.400	535.000
Janar-Gusht 2018	316.800	363.300
TOTAL	2.191.200	2.394.300

ILDKPKI në raportin e hartuar arrin në konkluzionin se prindërit e bashkëshortes time sipas dokumentacionit të paraqitur rezultojnë të punësuar me paga të ulëta por pa bërë përlllogaritjen e këtyre pagave ku referuar sa më sipër rezulton që nga viti 2012 (sipas sistemit të ISSH, vënë në dispozicion të ILDKPKI) e deri në momentin e blerjes së apartamentin arrijnë në shumën 4.585.500 Lekë.

Nga përlllogaritja e të ardhurave të bashkëshortes time (në shumën 3.265.583 lekë konfirmuar nga ILDKPKI) dhe prindërve të saj referuar dokumentacionit të paraqitur pranë ILKPKI nga viti 2012 e deri në blerjen e apartamentit të ardhurat në total rezultojnë në shumën 7.851.083 Lekë, shumë e cila justifikon burimin ligjor për blerjen e këtij apartamenti, pa marrë parasysh kursimet e prindërve të bashkëshortes nga puna ndër vite para vitit 2012, referuar librezave të tyre të punës, vërtetimeve të Arkivit Qëndror, vërtetimit të Raiffeisen Bank për depozitën e vitit 2005 (në shumën rreth 1.000.000 lekë).

Gjithashtu kam sqaruar se referuar deklaratës noteriale nr. {...} Rep, nr. {...} Kol, datë {...}, nga prindërit e bashkëshortes time nuk rezulton të jenë kryer blerje ose investime në pasuri të tjera, përveç kontributit për blerjen e apartamentit dhe makinës nga ana e vajzës së tyre (bashkëshortes time{...}{...}).

Në lidhje me pretendimin e ILDKPKI për mospasjen e informacionit për prindërit e bashkëshortes në lidhje me investime në pasuri, asete apo shpenzime të tjera, sqaroj se përveç deklaratave noteriale të mbajtura nga ana tyre, nuk disponojnë asnjë dokument tjetër pasi nuk kanë kryer investime të tilla e për rrjedhojë nuk mund ta provojnë këtë fakt.

Referuar deklaratës noteriale, përsa i përket kostove të shpenzimeve për konsum familjar për familjen e bashkëshortes, përllogaritja e bërë nga ILDKPKI është e lartë në raport me jetesën e tyre, pasi prindërit e bashkëshortes kanë pasur shpenzime minimale duke pasur në konsideratë faktin se numri i anëtarëve të familjes ishin 3 persona ndër të cilët 2 prindërit kanë qenë të punësuar vazhdimisht, ndërsa bashkëshortja ime e punësuar që prej vitit 2014. Gjithashtu, në lidhje me rritjen dhe arsimimin e vajzës së tyre (bashkëshortes time {...}{...}) kanë pasur shpenzime minimale për shkak të arsimimit të saj në institucione arsimore publike, konkretisht: në shkollën 8 vjecare “{...}”, shkollën e mesme “{...}” dhe studimet universitare pranë “{...}”{...}

Në lidhje me pretendimin e ILDKPKI se: “deklarata e prindërve të bashkëshortes time për arsimimin e vajzës së tyre (bashkëshortja ime) në shkolla publike bie poshtë për faktin se ka ndjekur një kurs në Amerikë” nuk qëndron dhe po keqinterpretohet nga ana tyre pasi referuar kësaj deklarate, nga ana tyre janë deklaruar institucione arsimore publike, konkretisht: në shkollën 8 vjecare “{...}”, shkollën e mesme “{...}” dhe studimet universitare pranë “{...}”{...} (pra periudha nga moshë 6 vjeç deri në moshën 23 vjeç) ndërsa kursi afatshkurtër 2 javore që ka ndjekur në {...} (jo shkollë) është paguar nga ana e bashkëshortes time dhe jo nga ana e prindërve të saj. (bazuar kjo dhe në përgjigjen e bankës Credins për ILDKPKI).

Në lidhje me kursin e ndjekur nga bashkëshortja ime në {...} sqaroj se ky kurs është ndjekur nga një grup shoqëror prej 5 vetash nga Shqipëria, ndër to edhe bashkëshortja ime dhe qëndrimi është mbuluar nga një prej familjarëve të shoqes së bashkëshortes, nëpërmjet bankës. Për shkak të kohës në dispozicion për të përgatitur kundërshtimet kam paraqitur nëpërmjet emailit të datës {...} pranë Jush kopje të çekut bankar (pagesë e kryer nga një nga të afërmit e një nga shoqet që ka ndjekur kursin, konkretisht paguar nga {...}) për shpenzimet e qëndrimit të bashkëshortes time {...}{...} në {...}, për periudhën 2 javore (8-23 Maj 2016).

Në lidhje me koston e shpenzimeve për konsum familjar për familjen e bashkëshortes, bazuar në deklaratën noteriale nr. {...}Rep, nr. {...}Kol, datë {...}, prindërit e bashkëshortes kanë deklaruar se për shkak të marrëdhënieve të posaçme me punëdhënësin {...} (nipi i {...} {...}) dhe njëkohësisht edhe shitësi i apartamentit) nuk kanë pasur shpenzime në veshmbathje, pasi dhuroheshin nga ana e tij në shenjë mirënjohje përfshirë këtu edhe veshje të cilat për shkak të defekteve të vogla nga fabrika nuk i nxirrnin në shitje. Gjithashtu, prindërit e bashkëshortes kanë deklaruar se gjatë periudhës së punësimit si shitës rreth 15 vite kanë përfituar edhe shuma të vogla të hollash nga ana e klientëve në formë bakshishesh, të cilat janë përdorur nga ana e tyre në mbulimin e shpenzimeve për konsum familjar. Këto fakte provohen edhe nga vërtetimi i punëdhënësit {...} të datës {...} i cili nuk është marrë parasysh nga ILDKPKI.

Në deklaratë nga ana e bashkëshortes time është sqaruar fakti se apartamenti ndodhet në një banesë private 3 katëshe (me 3 apartamente) e ndërtuar në vitin 1999 nga babai i saj z. {...}{...} (pronar i katit 2) dhe dy bashkëpronarët e tjerë z. {...} ({...}), pronar i katit 1 dhe z. {...} ({...}), pronar i katit 3 (apartamentit 3). Apartamenti i është blerë kushëririt dhe bashkëpronarit z. {...} ({...}), i cili është njëkohësisht edhe punëdhënësi i prindërve të saj. Banesa e përbashkët është ndërtuar me një kosto minimale për kohën e ndërtimit duke marrë parasysh faktin se është ndërtuar me kontribut fizik nga babai i bashkëshortes, me profesion ndërtues (usta, murator) dhe materialet e përdorura në ndërtimin e banesës kanë pasur kosto të ulët në raport me periudhën e ndërtimit.

ILDKPKI i është vënë në dispozicion nga ana ime dhe nga ISSH vërtetimi për të ardhurat e prindërve të bashkëshortes time: z. {...}{...} dhe zj. {...}{...} të hedhura në sistem nga viti 2012 e në vazhdim dhe nuk ka marrë parasysh faktin se ata kanë qenë të punësuar prej shumë vitesh para vitit 2012, të dhëna të cilat pasqyrohen saktësisht në librezat e tyre të punës si vijon:

- a) {...}{...}{...} ka qenë i punësuar nga viti 1980 e në vazhdim referuar Librezës së punës nr. i Regjistrimit Themeltar {...}.
- b) {...} {...}{...} ka qenë i punësuar nga viti 1990 e në vazhdim referuar Librezës së punës nr. i Regjistrimit Themeltar {...}.

Në lidhje me periudhën para vitit 2012, periudha e trajtimit social, ku rezultojnë si të papunë është përafërsisht 2 vjet (1 vit në vitin 1992 dhe 1 vit në vitin 1999, kohë kur me punën dhe angazhimin e tyre i janë përkushtuar ndërtimit të banesës familjare bashkë me bashkëpronarët e tjerë, deklaruar kjo (viti i ndërtimit të banesës) edhe në deklaratës noteriale nr. {...} Rep, nr. {...} Kol, datë {...}). Pra, nga gjithë periudha para vitit 2012 rezultojnë të kenë qenë të papunë vetëm 2 vjet (ku janë trajtuar me asistencë sociale) ndërsa për vitet e tjera rezultojnë të kenë qenë të punësuar bazuar në librezat e punës si dhe të deklaratës noteriale nr. {...} Rep, nr. {...} Kol, datë {...}.

Gjithashtu kam vënë në dispozicion vërtetimet e pagave për prindërit e bashkëshortes të siguruara pjesërisht nga Drejtoria e Arkivit Qëndror me nr. {...} Prot, datë {...} si dhe nga ISSH me nr {...} Prot, datë {...}. Këto vërtetime nuk janë të plota për shkak edhe të emrave të prindërve të bashkëshortes ku në disa raste babai e ka të shënuar {...}e në disa {...} dhe nëna në disa raste {...} e në disa {...}, duke bërë të pamundur sigurimin e dokumentacionit të plotë të kërkuar.

Në deklaratën noteriale nr. {...} Rep, nr. {...} Kol, datë {...}, babai i bashkëshortes {...}{...} ka deklaruar se në lidhje me periudhën rreth viteve 1999-2011 ka qenë i pasiguar dhe ka punuar si i vetëpunësuar usta (murator), duke ushtruar këtë zana privatisht. Në këtë periudhë ka pasur një numër të lartë ndërtimesh kryesisht të banesave private dhe shtesave të tyre, punë e mirëpaguar. Të ardhurat nga kjo punë, sikurse pjesa më e madhe e shqiptarëve nuk janë të formalizuara, por janë të siguruara me mund dhe djersë duke shërbyer si shpenzime familjare dhe si pjesë e kursimeve ndër vite (cash dhe në depozita bankare). Gjithashtu, për periudhën që ka qenë i punësuar sipas Librezës së punës në firma ndërtimi, paga e marrë ka qenë shumë herë më e lartë se ajo e deklaruar nga punëdhënësi (siç ndodh rëndomtë edhe sot ku shumë subjekte deklarojnë pagën minimale për efekt sigurimesh), por dhe për shkak se merrej cash nuk i kushtonin rëndësi këtij fakti. Këtë zana kryesisht në punime të vogla e ka ushtruar deri vonë në banesat e familjarëve e të njohurve të tjerë gjatë fundjavave dhe mbasditëve, pavarsisht se ka qenë i punësuar si shitës.

Në deklaratën noteriale nr. {...} Rep, nr. {...} Kol, datë {...}, nëna e bashkëshortes {...}{...} ka deklaruar se për periudhën rreth tetor 1993 - dhjetor 1996 si dhe në shkurt 2003 ka qenë e vetëpunësuar si shitëse ambulante veshjesh pranë ish-stacionit të trenit {...} si dhe pranë rrugës së {...}, përball ish-{-...}

Sa më sipër, konstatimi i ILDKPKI për mungesë burimi financiar të ligjshëm lidhur me blerjen e apartamentit në {...}, në shumën 5.000.000 lekë, nga shtetasja {...}{...}, nuk qëndron për arsye se:

- 1- *Të ardhurat e realizuara ndër vite nga bashkëshortja dhe prindërit e saj janë të mjaftueshme dhe nga burime financiare të ligjshme në raport me kohën, për të mbuluar blerjen e apartamentit. Vetëm nga viti 2012 e deri në blerjen e apartamentit të ardhurat në total rezultojnë në shumën 7.851.083 Lekë, shumë nga e cila justifikohet shuma 5.000.000 lekë për blerjen e apartamentit. ILDKPKI ka zbritur shumën rreth 4.064.000 lekë si shpenzime për konsum familjar për këtë periudhë, shumë tepër e lartë dhe e papranueshme për një familje modeste pa marrë parasysh provat e vëna në dispozicion;*
- 2- *Në përlllogaritjen e të ardhurave nuk janë llogaritur të ardhurat që ata kanë përfituar nga interesat e depozitave bankare nga viti 2005 (sipas të dhënave që dispononte Raiffeisen Bank vënë në dispozicion), si dhe interesat nga Fondi i Investimeve për bashkëshorten time të përmendura dhe nga ILDKPKI në shumën rreth 50.000 lekë;*
- 3- *Në Raportin e ILDKPKI nuk janë marrë parasysh të ardhurat e realizuara nga prindërit e bashkëshortes para vitit 2012, ku rezultojnë të punësuar sipas librezave të punës, deklaratave noteriale si dhe vërtetimeve të pagave për prindërit e bashkëshortes të siguruara pjesërisht nga Drejtoria e Arkivit Qëndror me nr. {...}Prot, datë {...}si dhe nga ISSH me nr 8314 Prot, datë 06.09.2019. Këto vërtetime nuk janë të plota për shkak edhe të emrave të prindërve të bashkëshortes ku në disa raste babai e ka të shënuar {...}e në disa {...} dhe nëna në disa raste {...} e në disa {...}, si dhe në disa muaj mungojnë listpagesat duke bërë të pamundur sigurimin e dokumentacionit të plotë të kërkuar.*
- 4- *Të ardhurat dhe kursimet para vitit 2012 rezultojnë në shuma të konsiderueshme vetëm duke marrë parasysh depozitën e prindërve të bashkëshortes nga viti 2005 në shumën rreth 1.000.000 lekë (vënë në dispozicion të ILDKPKI Statement Banka Raiffeisen) dhe kursime të tjera në gjendje cash.*
ILDKPKI nuk e ka marrë parasysh këtë depozitë në shumën rreth 1.000.000 lekë e akumuluar nga kursimet e prindërve të bashkëshortes ndër vite;
- 5- *Përsa i përket kostove të shpenzimeve për konsum familjar për familjen e bashkëshortes, përlllogaritja e bërë nga ILDKPKI është e lartë në raport me jetesën e tyre dhe faktit që kanë qenë 3 anëtarë në familje, ndër to dy të punësuar rregullisht dhe i treti (bashkëshortja ime) nga viti 2014. ILDKPKI në lidhje me shpenzimet për konsum familjar të familjes së bashkëshortes time ndjek po të njëjtën përlllogaritje dhe standart si për një familje të një subjekti kontrolli për rivlerësim kalimtar dhe jo të një familje me shpenzime modeste, pa marrë parasysh provat në tërësi. Shuma rreth 4.064.000 lekë si shpenzime për konsum familjar nga vitit 2012 deri ne gusht 2017 për një familje me 3 anëtarë është tepër e lartë dhe e papranueshme pasi përveç faktit se është ndjekur standarti i një familje të një subjekti kontrolli për rivlerësim kalimtar, nuk janë marrë parasysh aspak provat e vëna në dispozicion që vërtetojnë mënyrën e jetesës, shpenzimet minimale, përfitimet nga puna etj, prova kto që rrëzojnë përlllogaritjen e ILDKPKI.*
- 6- *ILDKPKI nuk ka marrë parasysh deklaratat noteriale të prindërve të bashkëshortes të cilët deklarojnë me përgjegjësi të plotë për punët e realizuara nga ana e tyre ndër vite me djersë e me mund, kryesisht të babait i cili ka punuar privatisht si usta gjatë viteve 1999-2011 (sqaruar më lart).*
- 7- *Gjithashtu, ILDKPKI nuk ka marrë parasysh deklaratat noteriale të prindërve të bashkëshortes në lidhje me shpenzimet për konsum familjar të cilat kanë qënë minimale*

ku një pjesë e mirë mbuloheshin nga bakshishet që akumulonin nga shitjet e realizuara në punën e tyre si shitës, ndërsa veshjet siguroheshin kryesisht nga puna. Pagat e prindërve të bashkëshortes si shitës në shuma modeste janë edhe për shkak të faktit të përfitimit të të hollave në formë bakshishesh gjatë ditës nga klientë të ndryshëm, fakt i njohur publik. Këto fakte përforcohet edhe më shumë edhe nga vërtetimi i punëdhënësi {...} të datës {...}, dokument ky i vënë në dispozicion në përgjigje të pretendimeve të ILDKPKI për mungesë dokumentacioni provues.

- 8- Sa më sipër, të ardhurat për blerjen e apartamentit në Tiranë, në shumën 5.000.000 lekë, nga shtetasja {...} {...} (bashkëshortja ime si person i lidhur) me të ardhurat nga puna e saj dhe të prindërve të saj ndër vite, janë nga burime të ligjshme dhe të justifikueshme. Dyshimet e ILDKPKI në lidhje me mungesën e dokumentacionit përkatës për të ardhurat e realizuara nga prindërit e bashkëshortes në një periudhë të caktuar të vërtetuara me deklarata noteriale, për shkak të kohës së realizuar, dhe faktit që bashkëshortja prej rreth 1 viti është person i lidhur me mua, nuk mund të përbëjnë shkak për penalizimin tim në të drejtën për të filluar studimet për formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës.

6) Në lidhje me konstatimin “Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor mbi dhuratat nga dasma në shumën 900.000 lekë dhe mbi shpenzimet martesore në shumën 800.000 lekë, deklaruar në vitin 2018”:

Siç kam sqaruar edhe në observacionet e mëparshme këtë informacion e kam dhënë vetëm në Deklaratën periodike të pasurisë për vitin 2018 të babait tim z. {...} {...} si person i lidhur me të, për të qënë sa më transparent para ILDKPKI dhe çdo organi tjetër që shqyrton këto deklarata. Për këtë sqaroj faktin se mosparaqitja e dokumentacionit justifikues lidhur me shpenzimet e dasmës ka ardhur për shkak të formatit të Deklaratës periodike të babait tim, e cila nuk parashikonte paraqitjen e dokumentave justifikues. Në lidhje me shpenzimet martesore kam deklaruar shumën 800.000 lekë, ku nga këto darka e dasmës të organizuar pranë ambjenteve të {...} (sipas vërtetimit të lëshuar nga përfaqësuesi i subjektit {...}, provë e cila nuk është marrë parasysh nga ILDKPKI) në shumën 600.000 lekë të paguara cash pas darkës së martesës (vënë në dispozicion të ILDKPKI) + 200.000 lekë shpenzime të ndryshme. Kam sqaruar se këto shpenzime janë mbuluar nga dhuratat e dasmës.

Gjithashtu, dhuratat nga dasma në shumën 900.000 Lekë cash të përdorura vetëm për mbulimin e shpenzimeve të dasmës, kanë ardhur nga të ftuarit, miqtë dhe të afërm të familjes sipas traditës dhe e vlerësoj të pamundur vënien në dispozicion të ndonjë dokumenti justifikues për këtë fakt, pasi është jashtë etikës dhe të drejtës zakonore shqiptare t’iu kërkoj 200 të ftuarve deklarata noteriale për të vërtetuar këtë fakt konfidencial të cilat nuk kanë qënë dhurata në shuma me detyrim për tu deklaruar (Sqaroj se dhuratat për secilin nga të ftuarit kanë qënë në shuma të vogla nga rreth 200 të ftuar). Gjithashtu nuk do të ishte aspak morale nga ana ime nëse do të justifikohesha duke marrë deklarata noteriale të vërteta apo qoftë edhe fiktive thjesht për të vërtetuar këtë fakt të njohur botërisht. Këtë sqarim nga ana ime e lë në vlerësim të bindjes Tuaj të brendshme të bazuar në traditën dhe sjelljen zakonore shqiptare.

Sa më sipër, qëllimi i këtij deklarimi është dhënë për një transparencë sa më të plotë para ILDKPKI dhe çdo organi tjetër nga ana ime si person i lidhur me babain tim {...} {...} dhe jo për të deklaruar si përfitim nga dasma siç keqinterpreton ILDKPKI.

7) Në lidhje me konstatimin e ILDKPKI për Aktin e Kontrollit të Plotë të Rivlerësimit Kalimtar për babain tim {...} {...}:

Në lidhje me kontratën e qerasë të lidhur me Bashkinë {...} ku sipas pretendimit të ILDKPKI babai im ka qënë në kushtet e konfliktit të interesit nuk qëndron për arsye se:

Kontrata e qerasë është lidhur në zbatim të VKM Nr. 369, datë 18.05.2016 “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i cili parashikon detyrimin e subjekteve private për lidhjen e kontratës së qerasë me institucionin e qeverisjes vendore për ushtrimin e këtij aktiviteti. Me hyrjen në fuqi të VKM Nr. 369, datë 18.05.2016, të gjithë subjektet tregtare që ushtronin aktivitetin e stacionit të plazhit pranë plazhit të {...} kishin detyrimin e lidhjes së kontratës së qerasë dhe të përmbushnin të gjithë detyrimet që rrjedhin prej saj, detyrim i cili është përmbushur edhe nga ana jonë. Kjo kontratë përbënte detyrim nga ana jonë si subjekt tregtar dhe nuk është përfituar nga babai im si zyrtar apo ne si persona të lidhur me të në mënyrë favorizuese apo si trajtim preferencial në raport me të tjerët dhe nuk përmban asnjë element të konfliktit të interesit. Ky fakt mund të provohet lehtësisht referuar vërtetimeve përkatëse për pagesat e detyrimeve ligjore, fillimisht pranë ish-Komunës Kryevideh {...} e më pas pranë Bashkisë {...} përkatësisht nga vëllai im {...} {...} fillimisht në vitin 2008, e më pas nga unë prej vitit 2010 e në vazhdim.

ILDKPKI në të gjitha Raportet që ka përpiluar në adresën time nuk është mbështetur në deklarinimin tim fillestar dhe në provat mbështetëse që unë kam paraqitur, por është mjaftuar vetëm me disa konstatime paragjyquese dhe të pakonfirmuara të deklarimeve të babait tim gjyqtar {...} {...} (të përsëritura në të gjitha Raportet) të cilat i kanë pasqyruar në Raportin tim, pa marrë asnjë shpjegim nga ai (babai im) si subjekt deklarues.

Në këto kushte, ndjehem i paragjykuar nga ILDKPKI në hartimin e këtyre raporteve duke më trajtuar si të isha gjyqtar dhe jo si kandidat për formim fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Ky qëndrim i ILDKPKI më mohon mua mundin dhe djersën time ndër vite duke studiuar dhe punuar me ndershmeri dhe duke më cënuar në të drejtën time morale dhe ligjore për të vazhduar studimet për formimin fillestar si gjyqtar në Shkollën e Magjistraturës.

Nga analiza financiare e ILDKPKI rezulton se unë dhe bashkëshortja ime kemi pasuri në shumën rreth 11.855.000 lekë dhe kemi realizuar të ardhura në shumën rreth 23.015.000 lekë, pa përfshirë këtu fitimin e realizuar nga aktiviteti privat në vitet 2010 - 2013 në shumën 7.500.000 lekë nga ana ime. Pra, nga kjo analizë pasqyrohet qartë se të ardhurat e ligjshme të realizuara ndër vite janë më shumë se dyfishi i pasurisë së deklaruar duke hedhur poshtë çdo dyshim në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme për pasurinë që disponoj.

Sa parashtrova në këtë Observacion, kontestoj konstatimet në Raportet e ILDKPKI-së (Aktin e përfundimit të kontrollit të plotë) pasi këto raporte janë përpiluar dhe kanë dalë në konkluzione të gabuara, pa marrë parasysh tërësisht provat e paraqitura dhe pa marrë shpjegime të hollësishme dhe argumente përkatëse nga ana ime si subjekt deklarues dhe kontrolli.

Në përfundim, në lidhje me pikat a) dhe b) të konstatimeve të ILDKPKI në këtë Raport, për arsyet e parashtruara më sipër, provoj se:

- a) Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b) Kam patur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë.*

Përsa më lart, ILDKPKI në të gjitha Raportet që ka përpiluar në adresën time nuk është mbështetur në deklarinimin tim fillestar dhe në provat mbështetëse që unë kam paraqitur, por është mjaftuar vetëm me disa konstatime të pakonfirmuara të deklarimeve të babait tim gjyqtar {...} {...} të cilat i kanë pasqyruar në Raportin tim, pa marrë asnjë shpjegim nga ai (babai im) si subjekt deklarues. Në këto kushte, ndjehem i paragjykuar nga ILDKPKI në hartimin e këtyre raporteve duke më trajtuar si të isha gjyqtar dhe jo si kandidat për formim fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Ky qëndrim i ILDKPKI më mohon mua mundin dhe djersën time ndër vite duke studiuar dhe punuar me ndershmeri dhe duke më cënuar në të drejtën time morale dhe ligjore për të vazhduar studimet për formimin fillestar si gjyqtar në Shkollën e Magjistraturës.

Kërkoj nga ana Juaj që Observacionet mbi konstatimet e Raporteve të ILDKPKI-së, të merren në konsideratë dhe të miratoni kandidaturën time si kandidat për formim fillestar në Shkollën e Magjistraturës, sipas ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

17. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...} u kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

17.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me shkresën nr. {...}prot., datë {...}.

17.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me shkresën nr. {...}prot., datë {...}, ku për kandidatin {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

18. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, duke u vlerësuar se nuk kishte vend për t’ju kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë.

19. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidatin {...}, janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të skualifikimit të tij nga kandidimi përse i përket kriterit të pasurisë, në referim të gërmës “a”, pika 4 e nenit 32 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe pikës 20 të Seksionit “A” të Kreut IX të vendimit nr. 75, datë 23.05.2019 të KLGJ-së “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

20. Fillimisht, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon të evidentojë se në konsideratë të të dhënave të përshkruara në Raportin Final të ILDKPKI-së (Raportin e Tretë Shtesë), të nxjerra ato nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati, por edhe nga korrespondenca e saj me subjekte shtetërore dhe private, dokumentacion ky që evidentohet hollësisht në Raport, sikundër dhe nga analiza financiare e bërë nga ky organ publik, përgjegjës për kontrollin e deklarinimit të pasurive dhe konfliktit të interesave sipas Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, konstatohet se Raporti është i plotë, i detajuar dhe i qartë, duke mos paraqitur ndonjë mangësi.

21. Ndërkohë, referuar të dhënave të rezultuara gjatë procesit të verifikimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se në rastin e kandidatit z. {...} vërtetohet që deklarimi nga ai i pasurisë dhe interesave privatë nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe se kandidati nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, rrethana këto që përbëjnë pengesë për pranimin e kandidatit në Shkollën e Magjistraturës, referuar nenit 32, pika 4, shkronja “a”, të Ligjit të Statusit, sipas të cilit “Në çdo rast, kandidati nuk pranohet në Shkollën e Magjistraturës kur: a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve; ...”.

22. Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndërsa konsideron të sakta disa nga konstatimet e ILDKPKI-së, vlerëson të pabazuara pretendimet e kandidatit në lidhje me to.

23. Këshilli vlerëson se për kandidatin z. {...} vërtetohet mungesë burimi financiar të ligjshëm në vlerën rreth 1.800.000 lekë, që sipas tij ka shërbyer për blerjen e apartamentit, pasurisë nr.146/38+-7, me sipërfaqe 74.7 m², për vlerën totale 33.400 euro, i ndodhur {...}, {...}.

23.1 Në deklaratën e pasurisë, kandidati ka deklaruar apartament banimi, fituar sipas Kontratës së Sipërmarrjes nr. {...} kol. dhe nr {...} rep., datë {...}, si dhe Kontratës së Shitblerjes nr. {...} rep. dhe nr. {...} kol., datë {...}. Si burim krijimi të kësaj pasurie, kandidati ka deklaruar të ardhurat familjare nga aktivitetet private familjare të nënës dhe vëllait, si dhe të ardhurat nga puna e vetë dhe e babait të tij si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}.

23.2 Nga analiza financiare lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, rezulton se më datë {...}, kur është likuiduar kësti i parë sipas Kontratës së Sipërmarrjes datë {...}, në vlerën 16.700 euro (rreth 2.340.000 lekë sipas kursit zyrtar të kohës), kandidati {...} dhe familja e tij prindërore ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të realizuar shlyerjen e këtij kësti, pikërisht në vlerën rreth 1.533.000 lekë. Konkretisht, në këtë datë, totali i të ardhurave familjare rezulton në vlerën 1.320.000 lekë. Nga ana tjetër, në këtë datë, shpenzimet llogariten në vlerën 513.000 lekë. Sa i përket shpenzimeve i janë nënshtruar vlerësimit dhe analizës vetëm shpenzimet e prezumuara për konsum familjar, të cilat, referuar të dhënave të INSTAT-it, llogariten jo më pak se vlera 513.000 lekë. Shpenzime të tjera të mundshme ndër vite, si për shembull mjekësore, arsimore, shëndetësore, pushimi, mobilimi, etj, në mungesë të informacioneve, nuk i janë nënshtruar vlerësimit dhe analizës. Nisur nga këto të dhëna, në këtë datë, mundësitë financiare të kandidatit për blerjen e apartamentit, p{...}in e kështit të parë, llogariten jo më shumë se në vlerën 807.000 lekë (2.340.000 lekë të ardhura - 513.000 lekë shpenzime jetese). Për rrjedhojë, kandidati, në këtë datë, ka mungesë të burimeve financiare për p{...}in e kështit të parë për blerjen e apartamentit në vlerën 1.533.000 lekë (2.340.000 lekë kësti - 807.000 lekë të ardhura të prezumuara gjendje).

23.3 Po ashtu, nga analiza financiare lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, rezulton se më datë {...}, kur është likuiduar kësti i dytë sipas Kontratës së Sipërmarrjes datë {...}, në vlerën 16.700 euro (rreth 2.293.000 lekë sipas kursit zyrtar të kohës), kandidati {...} dhe familja e tij prindërore ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të realizuar shlyerjen e këtij kësti, pikërisht në vlerën rreth 270.000 lekë. Konkretisht, në këtë datë, totali i të ardhurave familjare rezulton në vlerën 2.560.000 lekë. Nga ana tjetër, në këtë datë, shpenzimet llogariten në vlerën 537.000 lekë. Sa i përket shpenzimeve, edhe në këtë rast i janë nënshtruar

vlerësimet dhe analizës vetëm shpenzimet e prezumuara për konsum familjar, të cilat, referuar të dhënave të INSTAT-it, llogariten jo më pak se vlera 537.000 lekë. Nisur nga keto të dhëna, në këtë datë, mundësitë financiare të kandidatit për blerjen e apartamentit, p{...}in e këstit të dytë, llogariten jo më shumë se në vlerën 2.023.000 lekë (2.560.000 lekë të ardhura - 537.000 lekë shpenzime jetese). Për rrjedhojë, kandidati, në këtë datë, ka mungesë të burimeve financiare për p{...}in e këstit të dytë për blerjen e apartamentit në vlerën 270.000 lekë (2.560.000 lekë kësti - 2.023.000 lekë të ardhura të prezumuara gjendje).

23.4 Referuar të dhënave si më lart, konkludohet se burimet financiare të kandidatit dhe familjes së tij nuk justifikojnë shlyerjen e pagesës për blerjen e apartamentit, pasurisë nr.146/38+-7, me sipërfaqe 74.7 m², ndodhur në {...}, {...}, për një vlerë totale negative prej 1.803.000 lekë.

23.5 Pretendimet e kandidatit në lidhje me këtë përfundim çmohen të pabazuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Këto pretendime dhe dokumentet mbështetës të paraqitura nga kandidati janë trajtuar hollësisht në analizën financiare të bërë nga ILDKPKI-ja, trajtim ky që vlerësohet i saktë dhe në përputhje me ligjin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

23.5.1 Nuk qëndron pretendimi i kandidatit se shuma e realizuar si fitim nga aktiviteti privat për periudhën 2010-2013 është në vlerën 7.800.000 lekë. Pavarësisht pretendimeve të kandidatit, deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga aktiviteti privat duhet të shoqërohet për periudhën e deklaruar me dokumentacionin justifikues ligjor nga zyrat e tatim taksave, të cilët të konfirmojnë fitimin e realizuar. Sa më sipër, lidhur me këtë periudhë, është i pamundur konfirmimi nëse ky aktivitet ka realizuar fitim apo humbje dhe, për rrjedhojë, konfirmimi i fitimit të pretenduar, i cili sipas kandidatit është përdorur si burim në blerjen e këtij aseti. Gjithashtu, pretendimi i kandidatit për një fitim të përlogaritur në rreth 63% të qarkullimit vlerësohet tepër i lartë dhe i paargumentuar për llojin e aktivitetit që kryhet.

23.5.1.1 Referuar fitimit në vlerën 400.000 lekë të deklaruar për vitin 2014, sipas tabelës së dërguar nga DRT {...}, me shkresën nr. {...}prot., datë {...}, në seksionin komente DRT {...}, konfirmohet se është deklaruar e ndryshuar nga tatimpaguesi në datë 09.07.2019. Për rrjedhojë kjo shumë me të drejtë nuk është përfshirë tek fitimi i krijuar, pasi kandidati ka dorëzuar deklaratën e pasurisë dhe interesave private më datë {...}.

23.5.2 Lidhur me pretendimin e kandidatit se ILDKPKI ka marrë parasysht vetëm të ardhurat e deklaruara për 4 muajt e parë të vitit 2014 (kësti parë) dhe 4 muajt e parë të vitit 2015 (kësti i dytë) sipas Deklaratave periodike të babait të tij dhe jo të ardhurat e deklaruara në vitin 2013 e më parë në gjendje cash apo të akumuluar në depozita bankare, të deklaruara ndër vite nga babai i tij si të ardhura të ligjshme, Këshilli vlerëson se referuar kontratës së sipërmarrjes nr. {...} kol., nr. {...} rep., datë {...}, midis palës sipërmarrëse Shoqërisë “{...}” shpk dhe palës porositëse shtetasit {...}, me objekt porositjen e apartamentit me sipërfaqe 83.5 m², 1+1, i ndodhur në {...}, në shumën 33.400 euro, shumë e cila do të likuidohej me këste, ku kësti i parë në shumën 16.700 euro është paguar me nënshkrimin e kontratës ndërsa kësti i dytë në shumën 16.700 euro do paguhej për një vit nga momenti i nënshkrimit të kontratës. Për rrjedhojë, Këshilli vlerëson se përlogaritjet për shlyerjen e kësteve i referohen të ardhurave që subjekti dhe familjarët e tij kanë realizuar deri në datat e caktuara dhe të shlyera të kësteve të blerjes së kësaj pasurie, pikërisht më {...} dhe kësti i dytë një vit nga momenti i nënshkrimit të kontratës, pra më {...}.

23.5.2.1 Babai i subjektit (shtetasi {...} {...}) në deklaratën e interesave private “Periodik Vjetor 2013”, në seksionin e ndryshimeve të pasurive shtesa dhe pakësime, ka pasur detyrimin të deklarojë shtesat në rastin konkret të vlerës së likuiditeve CASH të cilat janë krijuar për periudhën nga data {...} deri më datë {...} dhe që kanë qenë gjendje në fund të vitit. Për rrjedhojë, pretendimi i kandidatit se për vitin 2013 ka teprica në shumën 3.607.534 lekë, të cilat janë përdorur në vitin 2014 për shlyerjen e këstit të parë për blerjen e apartamentit, nuk rezultojnë të jenë deklaruar teprica CASH në shumën 3.607.534 lekë. Për më tepër, referuar procesverbalit të mbajtur në ILDKPKI më datë 24.03.2015 me subjektin {...} {...} (babai i kandidatit), rezultojnë se ky i fundit është pyetur lidhur me gjendjen e likuiditetit cash në fund të vitit 2013, për të cilën ka deklaruar se ky likuiditet ka qenë në vlera minimale.

23.5.3 Lidhur me pretendimin e kandidatit se ILDKPKI nuk ka marrë parasysh tepricat e viteve paraardhës, pikërisht të ardhurat nga prodhimet bujqësore (sipas vërtetimit përkatës), të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i kandidatit {...} (aktiviteti sezonal për vitin 2014) dhe nënës së tij {...} {...} (aktiviteti i ushtruar përgjatë gjithë vitit 2014 - 2015), si dhe ka përllogaritur në shpenzimet për konsum familjar minimal edhe 2 gjyshërit, të cilët kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e tyre, Këshilli vlerëson se: referuar të ardhurave të krijuara nga prodhimet bujqësore gjatë periudhës 2004 - 2018 nga shtetasi {...} {...} (babai i kandidatit), të cilat sipas vërtetimit të vitit 2019 pretendohen që i janë shitur subjektit tregtar {...} me NIPT {...}, rezultojnë se nuk është paraqitur dokumentacion ligjor justifikues mbi marrëdhënien financiare të krijuar në periudhën e gjatë 14 vjeçare të bashkëpunimit të tyre, faturat e lëshuara për prodhimet bujqësore, transaksionet e pagesave ose faturat e likuidimeve, të cilat do të mund të krijonin bindjen e ekzistencës së marrëdhënies midis këtij shtetasi dhe subjektit tregtar {...}.

23.5.3.1 Pavarësisht se tek fitimi i realizuar nga aktiviteti tregtar me NIPT {...} i shtetases {...} {...}, me objekt aktiviteti “tregtim artikuj të ndryshëm, bar-restorant-piceri, stacion plazhi, fast food” (sipas ekstraktit historik), është përllogaritur ai që subjekti ka deklaruar në fund të vitit fiskal, duhet pasur në konsideratë që ky aktivitet tregtar arrin të realizojë pjesën kryesore të fitimit gjatë muajve të verës për shkak të veprimtarisë që kryen, periudhë e cila është pas likuidimit të kësteve për blerjen e apartamentit. Rezultojnë gjithashtu se nga ILDKPKI-ja është marrë në konsideratë fitimi i realizuar, bazuar në të dhënat e ardhura nga institucionet kompetente shtetërore.

23.5.3.2 Në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet për të dy gjyshërit e subjektit rezultojnë se nga ILDKPKI-ja është marrë parasysh dokumentacioni që ka paraqitur subjekti lidhur me to dhe janë përllogaritur shpenzimet sipas nivelit të konsumit minimal për shtetas caktuar nga INSTAT.

23.5.4 Lidhur me pretendimin e kandidatit se fakti që familja e tij në vitin 2014 i ka dhënë hua shtetasit {...} apo ka investuar në Fondin e Investimit tregon se të ardhurat për pagesën e apartamentit kanë qenë të mjaftueshme apo se në përllogaritjen e të ardhurave për periudhën 4-mujore të vitit 2015, ILDKPKI-ja nuk ka marrë parasysh kthimin e borxhit në shumën 1.000.000 lekë cash para pagesës së këstit të dytë, por kthimin e këtij borxhi e ka llogaritur përgjatë gjithë vitit 2015 dhe me qëllim saktësimin e dyshimeve të ILDKPKI-së në lidhje me këtë fakt, pra të kthimit të borxhit në fillim të vitit 2015, ka vënë në dispozicion deklaratën

noteriale të huamarrësit {...} nr. {...} rep. {...} kol. të datës {...}, ku vërtetohet se huaja në shumën 1.000.000 lekë është kthyer në datën {...}, Këshilli vlerëson se vlera 2.000.000 lekë e dhënë hua, ka si burim të deklaruar, sipas deklarimit, tërheqjen nga Banka ISP, e cila është marrë parasys.

23.5.4.1 Lidhur me kontratën e huasë nr. {...}, datë {...}, në vlerën 2.000.000 lekë, palët kanë rënë dakord që kësti i parë në shumën 1.000.000 lekë do të shlyhet brenda datës {...}. Rezulton që shuma 1.000.000 lekë nga shlyerja e huasë të jetë përfshirë në përlllogaritjet e kryer në aktin përfundimtar të ILDKPKI-së.

23.5.4.2 Lidhur me huanë e dhënë në vitin 2014, në shumën 2.000.000 lekë, me interes 10% dhe shlyerjen e saj në shumën totale 2.400.000 lekë, në Aktin e Përfundimit të Kontrollit të Plotë Vetting të subjektit {...} {...}, me funksion gjyqtar, është konstatuar se nuk janë paguar detyrimet tatimore për interesat e përfituara, cka bën që këto të ardhura të mos konsiderohen të ligjshme sipas Aneksit të Kushtetutës, neni D, pika 3.

23.5.5 Lidhur me pretendimin e kandidatit se në deklaratimet e këtyre viteve rezulton se babai i tij ka përfitur interesa të konsiderueshme nga bankat, fakt që tregon se në llogaritë bankare ka pasur shuma të konsiderueshme, të mjaftueshme dhe të ligjshme për të mbuluar pagesën e apartamentit, Këshilli vlerëson se lidhur me të ardhurat që babai i kandidatit ka pasur ndër vite, të cilat kanë shërbyer për krijimin e llogarive të tij bankare, ILDKPI-ja është shprehur në Aktin e Përfundimit të Kontrollit të Plotë Vetting të subjektit {...} {...}, me funksion gjyqtar lidhur me mjaftueshmërinë dhe ligjshmërinë e tyre.

23.5.6 Lidhur me pretendimin e kandidatit se ILDKPKI-ja, shpenzimet për konsum familjar minimal i ka përlllogaritur për 7 persona duke përfshirë edhe gjyshërit, por në deklaratat e pasurisë nuk janë deklaruar pensionet respektive të gjyshërve, si dhe të ardhurat e gjyshes nga pagesa e verbërisë, Bashkia {...} pasi këto të ardhura nuk kanë qenë të detyrueshme për t'u deklaruar ndër vite nga babai i tij si subjekt deklarues, të ardhura të deklaruara në Deklarimin e Përgjithshëm Vetting, si dhe lidhur me pretendimin se ILDKPKI-ja nuk i ka përlllogaritur si të ardhura të familjes të ardhurat e gjyshërve sipas trajtimit të bërë nga kandidati, Këshilli vlerëson se, bazuar në atë çka është paraqitur në raportin e ILDKPKI-së, rezulton se lidhur me të ardhurat e përfituara nga gjyshërit e kandidatit, ILDKPKI-ja ka përlllogaritur të gjithë të ardhurat që subjekti ka paraqitur me dokumentacion dhe njëkohësisht në analizën financiare janë përfshirë, për efekt përlllogaritje, edhe tek shpenzimet minimale sipas INSTAT.

23.5.7 Lidhur me pretendimin e kandidatit se kosto minimale për jetesë nuk është në vlerën e përlllogaritur nga ILDKPKI-ja, pasi rreth 50% e kësaj vlere përballohej nga prodhimet bujqësore e blegtorale të deklaruara ndër vite që përdorëshin drejtpërdrejt për ushqim familjar, si dhe faktit që të gjithë mallrat ushqimorë dhe industriale merreshin me çmimin e shumicës në marketin ku ushtronte aktivitetin nëna e tij që prej vitit 2002, Këshilli vlerëson se lidhur me prodhimet bujqësore dhe konsumin familjar, nga ILDKPKI-ja, në përlllogaritje, janë marrë gjithmonë si referencë të dhënat e nxjerra nga INSTAT për konsumin minimal. Lidhur me pretendimet e mësipërme rezulton se kandidati nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të provuar të kundërtën mbi konsumin që ai ose familjaret e tij kanë patur.

23.5.8 Lidhur me pretendimin e kandidatit se pakujdesitë në deklaratimet e bëra nga babai i tij {...} {...}, duke mos deklaruar tepricat (në vitin 2013 në shumën 3.607.534 lekë dhe në vitin

2014 në shumën 2.756.502 lekë, në total rreth 6.300.000 lekë të ardhura të njohura dhe deklaruar nga ILDKPKI), nuk mund të përbëjnë mungesë burimi të ligjshëm për blerjen e apartamentit, duke u bërë shkak për penalizimin e tij në të drejtën e tij për të filluar studimet për formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, Këshilli vlerëson se në deklaratën e interesave private, subjekti ndër të tjera ka detyrimin të deklarojë shtesat e krijuara gjatë vitit të deklarimit. Mosdeklarimi i këtyre shtesave, i cili në vlerësimin e Këshillit nuk mund të përbëjë një pakujdesi, sjell si pasoje mosllogaritjen e tyre dhe, si rrjedhojë, pretendimet e kandidatit mbeten të paprovuara lidhur me këtë moment. Vlen të theksohet gjithashtu se, përveç faktit që këto teprica të pretenduara nuk janë deklaruar si të tilla, babai i kandidatit nuk i ka deklaruar ato as kur është pyetur, në vitin 2015, pikërisht për gjendjen cash në vitin 2013, ndërsa ka deklaruar se tepricat në gjendje cash kanë qënë minimale.

23.5.9 Në këto kushte, Këshilli vlerëson se kandidati ka mungesë burimi financiar të ligjshëm për shumën rreth 1.800.000 lekë për blerjen e apartamentit me nr. 146/38+2-7, me sipërfaqje 74.7 m², në vlerën totale 33.400 euro, i ndodhur në {...}. Njëkohësisht duhet pasur në konsideratë se vlerat e nxjerra duhet të merren me rezervë për familjen {...}, pasi nuk ka informacion nëse këta shtetas kanë kryer shpenzime private gjatë kësaj periudhe jashtë territorit të Shqipërisë apo shpenzime të tjera që ata mund të kenë kryer në vlera konkrete të cilat nuk janë përfshirë.

24. Këshilli vlerëson se për kandidatin z. {...} vërtetohet mungesë burimi financiar të ligjshëm në vlerën rreth 2.582.055 lekë, e cila ka shërbyer për blerjen e një apartamenti, në katin e dytë të një objekti, me sipërfaqje 127,4 m², për vlerën totale 5.000.000 lekë, i ndodhur në {...}, Rruga "{...}", blerë nga personi i lidhur, bashkëshortja e tij, shtetësja {...}{...}, gjatë martesës.

24.1 Në deklaratën e pasurisë, bashkëshortja e kandidatit ka deklaruar apartament banimi, fituar sipas Kontratës së Shitblerjes nr. {...} rep. dhe nr. {...} kol., datë {...}, me vlerë 5.000.000 lekë, me pjesë takuese 100%. Si burim krijimi, bashkëshortja e kandidatit ka deklaruar të ardhurat nga puna e saj, si dhe të ardhurat dhe kursimet e prindërve të saj. Kjo pasuri rezulton të jetë blerë gjatë martesës së shtetasës {...}{...} me kandidatin z. {...}.

24.2 Nga analiza financiare lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, rezulton se, më datë {...}, kur është bërë pagesa e çmimit të blerjes së apartamentit sipas Kontratës së Shitblerjes datë {...}, bashkëshortja e kandidatit dhe prindërit e saj kanë mungesë të burimeve financiare për të realizuar shlyerjen e këtij çmimi në vlerën rreth 2.582.000 lekë. Konkretisht, në këtë datë, totali i të ardhurave të tyre rezulton të ketë qënë në vlerën 7.150.945 lekë. Nga ana tjetër, në këtë datë, shpenzimet llogariten në vlerën 4.733.000 lekë. Sa i përket shpenzimeve të bashkëshortes së kandidatit dhe prindërve të saj, i janë nënshtruar vlerësimit dhe analizës vetëm tre lloj shpenzimesh të deklaruar apo të prezumuara, konkretisht shpenzimet për konsum familjar, që referuar të dhënave të INSTAT-it llogariten jo më pak se vlera 4.064.000 lekë, shpenzimet për blerjen e një autoveture në vlerën 3.500 euro (apo 484.000 lekë), si dhe shpenzimet për kursin e ndjekur në {...} nga shtetësja {...}{...} në vlerën 1.525 USD (ose 185.000 lekë). Vlen të theksohet se nuk i janë nënshtruar vlerësimit dhe analizës as shpenzimet për ndërtimin e objektit, pjesë e të cilit është dhe një apartament (kati i parë i objektit) i deklaruar në pronësi të prindërve të bashkëshortes së kandidatit. Nisur nga këto të dhëna, në këtë datë, mundësitë financiare të bashkëshortes së kandidatit dhe prindërve të saj për blerjen e apartamentit, llogariten jo më shumë se në vlerën 2.417.945 lekë (7.150.945 lekë të ardhura - 4.733.000 lekë shpenzime), duke mos llogaritur këtu, rithekskohet, shpenzimet për ndërtimin e

objektit, pjesë e të cilit është dhe një apartament (kati i parë i objektit) i deklaruar në pronësi të prindërve të bashkëshortes së kandidatit. Për rrjedhojë, bashkëshortja e kandidatit dhe prindërit e saj, në këtë datë, kanë mungesë të burimeve financiare për p{...}in e çmimit të blerjes së apartamentit në vlerën 2.582.055 lekë (5.000.000 lekë çmimi - 2.417.945 lekë të ardhura të prezumuara gjendje).

24.3 Referuar të dhënave si më lart, konkludohet se burimet financiare të bashkëshortes së kandidatit dhe prindërve të saj nuk justifikojnë shlyerjen e pagesës për blerjen e apartamentit, kati i dytë i një objekti, me sipërfaqje 127,4 m², ndodhur në {...}, Rruga “{...}”, për një vlerë totale negative prej 2.582.055 lekë.

24.4 Pretendimet e kandidatit në lidhje me këtë përfundim çmohen të pabazuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Këto pretendime dhe dokumentet mbështetës të paraqitura nga kandidati janë trajtuar hollësisht në analizën financiare të bërë nga ILDKPKI-ja, trajtim ky që vlerësohet i saktë dhe në përputhje me ligjin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

24.4.1 Kandidati ka pretenduar se të ardhurat e realizuara ndër vite nga bashkëshortja dhe prindërit e saj janë të mjaftueshme dhe nga burime financiare të ligjshme në raport me kohën, për të mbuluar blerjen e apartamentit, pasi vetëm nga viti 2012 e deri në gusht të vitit 2018, të ardhurat në total rezultojnë në shumën 7.851.083 Lekë, shumë nga e cila justifikohet shuma 5.000.000 lekë për blerjen e apartamentit. Kandidati ka pretenduar se ILDKPKI-ja ka zbritur shumën rreth 4.064.000 lekë si shpenzime për konsum familjar për këtë periudhë, shumë tepër e lartë dhe e papranueshme për një familje modeste. Këshilli vlerëson se këto pretendime të kandidatit nuk qëndrojnë duke konsideruar se përlllogaritja e konsumit familjar nga ana e ILDKPI-së, duke marrë si referencë të dhënat nga INSTAT për konsumin minimal, është e drejtë dhe e bazuar në ligj.

24.4.2 Kandidati ka pretenduar se në përlllogaritjen e të ardhurave të bashkëshortes dhe prindërve të saj, nuk janë llogaritur të ardhurat që ata kanë përfituar nga interesat e depozitave bankare nga viti 2005 (sipas të dhënave që dispononte Raiffeisen Bank vënë në dispozicion), si dhe interesat nga Fondi i Investimeve për bashkëshorten e tij të përmendura dhe nga ILDKPKI në shumën rreth 50.000 lekë. Në analizë të raportit të ILDKPI-së dhe të pretendimeve të kandidatit, Këshilli vlerëson se në përlllogaritjen e të ardhurave të familjes {...} për mbulimin e shumës së paguar për blerjen e apartamentit, si dhe në mbulimin e shpenzimeve të kryera nga kjo familje, janë përlllogaritur të ardhurat sipas dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati. Referuar trajtimit të bërë në aktin e ILDKPKI-së, kandidati ka paraqitur në vazhdimësi dokumentacion për të ardhurat e realizuara nga prindërit e bashkëshortes për periudhën nga fillimi i punësimit të tyre deri në vitin 2011, për të materializuar konkretisht se cila ka qenë vlera monetare e përfituar, e cila ka shërbyer për të mbuluar gjithçka që ata kanë deklaruar duke përfshirë dhe depozitat e krijuara ndër vite e përdorimin e tyre të mëvonshëm. Nga librezat e punës të dorëzuara dhe nga vërtetimet rezultojnë që periudhat e punësimit nuk janë në vazhdimësi, janë trajtuar me asistencë, në periudha të ndryshme kjo familje përfiton vetëm një page për të përmbushur nevojat e konsumit familjar të tre pjesëtareve të saj (përsëmbull nga data 01.07.1999 deri në datë 06.04.2011, rezultojnë se shtetasi {...} {...} është pa punë).

24.4.3.1 Ndërsa, lidhur me interesat e përfituara nga fondi i investimeve në shumën rreth 50.000 lekë, në momentin që kjo shumë është tërhequr nga banka, ka kaluar në gjendje

likuiditetesh kesh. Për rrjedhojë në deklarin e bashkëshortes të gjendjes kesh në shumën 150.000 lekë, kjo shumë e përfituar është marrë në konsideratë.

24.4.3 Kandidati ka pretenduar se në Raportin e ILDKPKI-së nuk janë marrë parasysh të ardhurat e realizuara nga prindërit e bashkëshortes para vitit 2012, ku rezultojnë të punësuar sipas librezave të punës, deklaratave noteriale, si dhe vërtetimeve të pagave për prindërit e bashkëshortes të siguruara pjesërisht nga Drejtoria e Arkivit Qendror me nr. {...} Prot, datë {...}, si dhe nga ISSH me nr. {...} Prot, datë {...}, vërtetime të cilat nuk janë të plota për shkak edhe të emrave të prindërve të bashkëshortes ku në disa raste babai e ka të shënuar {...} e në disa {...} dhe nëna në disa raste {...} e në disa {...}, si dhe në disa muaj mungojnë listë pagesat duke bërë të pamundur sigurimin e dokumentacionit të plotë të kërkuar. Në lidhje me këtë pretendim, Këshilli vlerëson se ILDKPKI-ja me të drejtë, në përlllogaritjen e të ardhurave të familjes {...} për mbulimin e shumës së paguar për blerjen e apartamentit, i është referuar të gjithë të ardhurave për të cilat kandidati ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor. Në përlllogaritjen konkrete për të ardhura dhe shpenzimet janë trajtuar dhe marrë në konsideratë, sipas përlllogaritjes, të dhënat nga INSTAT lidhur me konsumin minimal për periudhën nga viti 2000 deri në momentin e blerjes së apartamentit. Të ardhurat e realizuara nga prindërit e bashkëshortes, të trajtuara në aktin e ILDKPKI-së, për periudhën nga viti 1986 deri në vitin 2000 janë në shumën totale rreth 483.000 lekë (381.825 lekë babai dhe 101.336 lekë nëna). Ndërkohë, ndërsa nuk ka të dhëna nga INSTAT për shpenzimet minimale të kësaj periudhe, mbetet të pranohet që kjo shumë ka shërbyer në mbulimin e shpenzimeve të familjes {...} për periudhën 14 vjeçare.

24.4.4 Kandidati ka deklaruar se të ardhurat dhe kursimet para vitit 2012 rezultojnë në shuma të konsiderueshme vetëm duke marrë parasysh depozitën e prindërve të bashkëshortes nga viti 2005 në shumën rreth 1.000.000 lekë (vënë në dispozicion të ILDKPKI-së Statement Banka Raiffeisen) dhe kursime të tjera në gjendje cash. Kandidati ka pretenduar se ILDKPKI-ja nuk e ka marrë parasysh këtë depozitë në shumën rreth 1.000.000 lekë, e akumuluar nga kursimet e prindërve të bashkëshortes ndër vite. Lidhur me këto pretendime, në konsideratë dhe të përfundimeve të raportit të ILDKPKI-së, Këshilli vlerëson se ILDKPKI-ja ka trajtuar të gjithë të ardhurat që kjo familje ka realizuar dhe, për rrjedhojë, të gjithë kursimet e krijuara ndër vite që derivojnë nga to. Kjo depozitë është krijuar në vitin 2005, por ajo është mbyllur në vitin 2006, duke u tërhequr shuma e parave. Vlen të theksohet edhe njëherë se nga librezat e punës të dorëzuara dhe nga vërtetimet përkatëse, rezulton që periudhat e punësimit të prindërve nuk janë në vazhdimësi; janë trajtuar me asistencë; në periudha të ndryshme kjo familje përfiton vetëm një pagë për të përmbushur nevojat e konsumit familjar të tre pjesëtareve të saj, fakte të cilat krijojnë bindjen e pamundësisë për të krijuar kursime apo edhe nëse ka patur kursime nga të ardhura informale, ato të jenë shpenzuar. *(Familja {...} për periudhën 2000-2012 sipas dokumentacionit të paraqitur ka realizuar të ardhura në shumën 2.041.000 lekë, sipas INSTAT një familje me tre persona për këtë periudhë ka konsum minimal për jetesë në shumën 4.921.000 lekë.)*

24.4.5 Lidhur me pretendimin e kandidatit se ILDKPKI-ja nuk ka marrë parasysh deklaratat noteriale të prindërve të bashkëshortes, të cilët deklarojnë me përgjegjësi të plotë për punët e realizuara nga ana e tyre ndër vite me djersë e me mund, kryesisht të babait i cili ka punuar privatisht si usta gjatë viteve 1999-2011, Këshilli, në analizë të raportit të ILDKPKI-së, vlerëson se në rastin konkret rezulton të jetë marrë parasysh çdo dokumentacion justifikues ligjor që është paraqitur nga kandidati, çdo përgjigje e ardhur nga institucionet kompetente, për

rrjedhje të gjithë dokumentacioni që konfirmon të ardhurat e ligjshme të prindërve të bashkëshortes së subjektit. Deklarimet e prindërve të bashkëshortes së kandidatit, të pakonfirmuara me dokumentacion ligjor, nuk mund të shërbejnë si prova për vërtetimin e të ardhurave në kuptim të ligjit.

24.4.6 Kandidati ka pretenduar se ILDKPKI-ja nuk ka marrë parasysh deklaratat noteriale të prindërve të bashkëshortes në lidhje me shpenzimet për konsum familjar të cilat kanë qenë minimale, ku një pjesë e mirë mbuloheshin nga bakshishet që akumulonin nga shitjet e realizuara në punën e tyre si shitës, ndërsa veshjet siguroheshin kryesisht nga puna. Ai ka pretenduar edhe se pagat e prindërve të bashkëshortes si shitës në shuma modeste janë edhe për shkak të faktit të përfitimit të të hollave në formë bakshishesh gjatë ditës nga klientë të ndryshëm, fakt i njohur publik. Sipas kandidatit, këto fakte përforcohen edhe më shumë edhe nga vërtetimi i punëdhënësit {...} i datës {...}, dokument ky i vënë në dispozicion në përgjigje të pretendimeve të ILDKPKI-së për mungesë dokumentacioni provues. Edhe për këto pretendime të kandidatit, Këshilli, sikurse dhe më sipër, vlerëson se për aq kohë sa të ardhurat e pretenduara nuk konfirmohen me dokumentacion ligjor, ato mbeten në kuadrin e pretendimeve të paprovuara dhe të pavërtetuara ligjërisht.

24.4.8 Duke i konsideruar pretendimet e kandidatit të pabazuara, Këshilli vlerëson se në rastin konkret rezulton mungesë burimi të ligjshëm në shumën totale rreth 2.500.000 lekë lidhur me blerjen e apartamentit në {...} me sipërfaqe 127,4 m², në shumën 5.000.000 lekë, nga shtetësja {...} {...}. Apartamenti është blerë pas lidhjes së martesë së kësaj shtetaseje me shtetasin {...}.

25. Këshilli vlerëson se për kandidatin z. {...} vërtetohet deklarim jo i saktë i pasurisë, konkretisht për të ardhurat nga dhuratat për martesë në shumën 900.000 lekë, si dhe për shpenzimet martesore në shumën 800.000 lekë.

25.1 Në *“Deklaratën e pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë”*, dorëzuar nga kandidati në ILDKPKI më datë {...}, konstatohet që ai të mos këtë deklaruar pasurinë: të ardhura nga dhuratat për martesë në shumën 900.000 lekë, si dhe shpenzime për martesë në shumën 800.000 lekë.

25.2 Nga ana tjetër, kandidati, në cilësinë e personit të lidhur, në deklaratën e interesave private periodik/vjetor 2018 të subjektit {...} {...}, ka deklaruar të ardhura nga dhuratat në dasmën e tij përfituar nga të ftuarit, miqtë dhe të afërm të familjes në vitin 2018, në shumën 900.000 lekë, si dhe shpenzime martesore në shumën 800.000 lekë.

25.3 Përveç deklarimit jo të saktë të pasurisë në *“Deklaratën e pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë”*, për kandidatin vërtetohet edhe mungesë dokumentacioni justifikues ligjor mbi këtë pasuri, pra të të ardhurave nga dhuratat për martesë në shumën 900.000 lekë, si dhe për shpenzimet martesore në shumën 800.000 lekë.

25.4 Pretendimet e kandidatit në lidhje me këtë përfundim çmohen të pabazuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Këto pretendime dhe dokumentet mbështetës të paraqitura nga kandidati janë trajtuar hollësisht në raportin e ILDKPKI-së, trajtim ky që vlerësohet i saktë dhe në përputhje me ligjin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

25.4.1 Është e vërtetë sikundër pretendon kandidati se në deklaratën e interesave private periodik/vjetor 2018, nuk ka qenë e detyrueshme paraqitja e dokumentacionit justifikues për të ardhurat dhe shpenzimet vjetore. Por një rrethanë e tillë nuk përjashtonte dokumentimin e tyre sipas ligjit.

Për të ardhurat e deklaruara nga dhuratat për martesë, ndërsa ato nuk janë të ardhura që përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale sipas Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në kushtet kur kandidati për vitin 2018 ka deklaruar të ardhura nga të gjitha burimet (dhurata, paga si i punësuar dhe paga si i vetëpunësuar), atëherë ai ka patur detyrimin sipas këtij ligji, për deklarimin e të ardhurave dhe për p{...}in, mbi këtë bazë, të tatimit mbi të ardhurat personale, detyrim të cilin duhet ta kishte përmbushur jo më vonë se data 30.04.2019.

Për shpenzimet e martesës, kandidati ka deklaruar shpenzime për ceremoninë e dasmës në shumën 600.000 lekë, si dhe 200.000 lekë shpenzime të ndryshme. Gjatë procesit të verifikimit, kandidati ka depozituar një vërtetim të lëshuar nga shtetasi {...}, si përfaqësues i Shoqërisë {...} & SPA, sipas të cilit ai ka organizuar dasmën e kandidatit, ku kanë qenë të ftuar 200 persona, kundrejt çmimit 600.000 lekë. Për këtë transaksion, ndërsa deklarohet të ketë qenë në një vlerë mbi 150.000 lekë, për vërtetimin e tij, kandidati nuk ka paraqitur faturë, dëftesë ose kupon tatimor, të lëshuar nga subjekti tatimpagues në përputhje me detyrimin e përcaktuar nga Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, si dhe sipas këkesave të Ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”. Dokumentimi i transaksionit në rastin konkret, pra furnizimi i mallrave dhe shërbimit, duhet të ishte bërë që në momentin që referohet të jetë kryer, ndërkohë që vërtetimi i paraqitur nga kandidati gjatë procesit të verifikimit nuk plotëson kërkesat e legjislacionit fiskal për dokumentimin e transaksionit dhe vërtetimin e vlerës reale të tij.

26. Këshilli vlerëson se për kandidatin z. {...} nuk vërtetohet deklarim jo i saktë i pasurisë, konkretisht për të ardhurat nga shitja e autoveturë Mercedes Benz CLK 270 CDI, si dhe për shpenzimet e blerjes së autoveturës Smart, ndryshe nga sa ka konkluduar ILDKPKI-ja, sikurse me të drejtë pretendohet nga kandidati.

26.1 Në deklaratën e pasurisë kandidati ka deklaruar pronësinë mbi një autoveturë Smart, me vlerë 300.000 lekë, për të ciën, si burim krijimi të saj, ka deklaruar të ardhurat nga shitja e autoveturës Mercedes Benz CLK 270 CDI, në vlerën 750.000 lekë, sipas Kontratës së Shitblerjes me nr. 1032 rep, nr. 347 kol, datë 02.03.2017.

26.2 Sipas Raportit, ILDKPKI-ja në këtë rast ka konstatuar se vlera e shitjes së autoveturës Mercedes Benz CLK 270 CDI, pas 6 vjetësh përdorim nga kandidati, është më e madhe se vlera e blerjes prej tij të kësaj autoveture në vitin 2001, konkretisht rreth 110.000 lekë. Po ashtu, ILDKPKI-ja ka konstatuar se p{...}i i çmimit të shitjes së kësaj autoveture është bërë me para në dorë jashtë zyrës noteriale. Gjithashtu, ILDKPKI-ja ka konstatuar se blerës i autoveturës Mercedes Benz CLK 270 CDI, është i njëjti person (F.K), i cili i ka shitur kandidatit autoveturën Smart, për vlerën 300.000 lekë, vlerë edhe kjo e paguar me para në dorë jashtë zyrës noteriale. Mbi këtë bazë, ILDKPKI-ja ka vlerësuar se krijohet dyshimi për saktësinë e deklarimeve të kandidatit në lidhje me vlerat reale të shitjes dhe blerjes së këtyre dy autoveturave.

26.3 Këshilli vlerëson se dyshimi për vlerat reale të shitjes dhe blerjes së autoveturave si më lart, për shkak se veprimet e pageses së çmimit të tyre janë kryer jashtë zyrës noteriale dhe jo me transaksione bankare, si dhe se janë kryer midis të njëjtave palë kontraktore, për atë kohë sa mbetet në nivelin e një dyshimi, nuk mund të konsiderohet si deklaram i pasaktë i pasurisë nga kandidati, në kuptim të nenit 32, pika 4, shkronja “a”, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu, Këshilli vlerëson se edhe fakti që çmimi i shitjes së autoveturës Mercedes Benz CLK 270 CDI është 110.000 lekë më i madh se çmimi i blerjes së tij, nuk përbën një fakt domethënës që vërteton pasaktësi në deklaramin e pasurisë nga kandidati, duke mbajtur në konsideratë për këtë se ky veprim juridik është kryer mbi bazën e lirisë kontraktore të palëve, i pakundërshtuar deri më sot, përveç edhe kohën e kryerjes së këtij veprimi juridik, në vitin 2017, pra disa kohë përpara kandidimit të z. {...}, ndërsa ai është një veprim i vetëm, i izoluar dhe jo një mënyrë sjellje e kandidatit, rrethana këto që pengojnë pranimin ndryshe të fakteve të dokumentuara në akte zyrtare, e për rrjedhojë konsiderimin e pasaktë të deklaramit të pasurisë nga kandidati.

27. Këshilli vlerëson se kandidati z. {...} nuk gjendet në situatë konfliktit të interesave, kjo sa i përket qenies së tij i dypunësuar, duke përfituar dy paga brenda të njëjtit muaj, për periudhat korrik-shtator 2013, korrik-gusht 2014, qershor-shtator 2016, qershor e shtator 2017 dhe qershor-shtator 2018, konkretisht pranë subjektit privat {...} dhe pranë Institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës apo pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

27.1 Në fakt, edhe ILDKPKI-ja, pavarësisht konstatimit të saj, nuk ka arsyetuar dhe konkluduar për qenien e kandidatit në situatën e konfliktit të interesave.

27.2 Nga ana tjetër, sikurse kandidati ka pretenduar, puna e tij si i vetëpunësuar nuk është një veprimtari që bie në kundërshtim me ligjin, konkretisht me legjislacionin e punës në përgjithësi, që nuk ndalon dypunësimin, por edhe me legjislacionin e posaçëm për Shërbimin e Provës apo për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, konkretisht Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.302, datë 25.3.2009, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin e funksionimin e shërbimit të provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative” (dalë për zbatimin e Ligjit nr.8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar) dhe Ligjin nr.9572, datë 03.07.2006, “Për autoritetin e mbikëqyrjes financiare”, i ndryshuar. Këshilli vlerëson se për këtë moment nuk konstatohen papajtueshmëri apo konflikt interesi, pasi nuk rezulton që detyrat funksionale të kandidatit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës apo pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të vijnë ndesh me aktivitetin privat sezonal të kandidatit.

28. Bazuar sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor, arrin në përfundimin se përsa i përket verifikimit të kriterit të pasurisë, në rastin konkret rezulton se kandidati {...} nuk arrin të kalojë me sukses verifikimin e këtij kriteri, për shkak të deklaramit jo të saktë dhe mungesës së burimeve financiare për të justifikuar pasurinë e tij, siç u analizua më sipër, në referim të nenit 32, pika 4, shkronja “a”, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Vlen të theksohet se burimet financiare për krijimin e pasurisë së kandidatit dhe bashkëshortes së tij, më së paku nuk justifikohen për një vlerë në total **prej 4.300.000 lekë**, vlerë kjo tepër e lartë, çka bën të pavend vënien në diskutim në këtë rast të parimit të proporcionalitetit.

C. Për kriterin e figurës sipas nenit 32 të Ligjit të Statusit

1. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

2. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, me përjashtim të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila nuk është ngritur ende.

3. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidatit {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari që çenojnë sigurinë kombëtare apo aktivite të kundërligjshme.

4. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, atij iu kërkua dhe ai plotësoi e depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë {...}, formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të të dhënave të tij në lidhje me figurën dhe integritetin.

4.1 Në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës, duke përcjellë në Këshill, me shkresën nr. {...} prot., datë {...}, Vendimin “Për miratimin e rezultateve të verifikimit”, sipas të cilit është vlerësuar se *“Subjekti deklarues {...} {...} {...}, kandidat për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.*

4.2 Po në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, me shkresën nr. {...} prot., datë {...}, ka dërguar në Këshill të dhënat për përbërësit e gjendjes civile edhe për kandidatin {...}, pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe në zyrat përkatëse të gjendjes civile.

4.2.1 Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, nëpunësi përgjegjës i strukturës së posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi kreu verifikimet e rastit, nuk konstatoi mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidati {...} në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Për pasojë, u vlerësua që nuk kishte vend për verifikim shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme.

5. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston ndonjë prej shkaqeve të skualifikimit nga formimi fillestar për në Shkollën e Magjistraturës sa i përket kriterit të figurës. Konkretisht, verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015;
 - b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij;
 - c) për kandidatin nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
 - ç) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
 - d) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës;
- dh) për kandidatin nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e tij mbi të cilën të ngrihen dyshime për pranueshmërinë e tij për në formimin fillestar për magistrat në Shkollën e Magjistraturës.

III. KONKLUZIONE

1. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

2. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati nuk përmbush të gjitha këto kritere, çka jep shkas për skualifikimin e tij. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për skualifikimin e kandidatit për në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 32, pika 4, shkronja “a” dhe pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, në nenin 86, shkronja “ë” dhe në nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Kreun VI, Seksioni Ç, pika 12, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Skualifikimin e kandidatit z. {...}, për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magistrat, profili gjyqtar, në vitin akademik 2019-2020.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
3. Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR